



Fakulteti i Mjekësisë
Universiteti i Prishtinës

RAPORT I PUNËS

**RAPORT I PUNËS SË MENAXHMENTIT TË FAKULTETIT TË MJEKËSISË
GJATË PERIUDHËS KOHORE: 15 MARS 2016 – 31 DHJETOR 2016**

AKTIVITETI NË SFERËN AKADEMIKE-SHKENCORE.....	3
Hartimi i strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020.....	3
<i>Hartimi i rregullorës së punës të shefave të degëve dhe katedrave</i>	<i>4</i>
<i>Hartimi i udhëzuesit për punimin e temave të diplomës</i>	<i>4</i>
<i>Hartimi i rregullores për studimet Master në Fakultetin e Mjekësisë.....</i>	<i>5</i>
<i>Akreditimi i programeve të Fakultetit të Mjekësisë</i>	<i>5</i>
<i>Themelimi i trupit këshillëdhënës të Fakultetit të Mjekësisë</i>	<i>6</i>
<i>Vazhdimi i ndërtimit të kredibilitetit të Fakultetit të Mjekësisë në aspektin e pranimin të studentëve</i>	<i>6</i>
<i>Përmbyllja e procesit të zgjedhjes dhe rizgjedhjes së stafit akademik nga konkursi 2015, si dhe zgjedhjes së stafit të angazhuar për vitin akademik 2016/2017</i>	<i>7</i>
<i>Databazat e rekomanduara për publikime shkencore të stafit të Fakultetit të Mjekësisë....</i>	<i>8</i>
<i>Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë</i>	<i>8</i>
<i>Marrëveshjet e bashkëpunimit.....</i>	<i>13</i>
<i>Rifreskimi i Katedrave.....</i>	<i>14</i>
<i>Krijimi i laboratorit e-lab</i>	<i>14</i>
<i>Krijimi i Qendrës Informativë të Barnave (QIB)</i>	<i>15</i>
<i>Krijimi i grupit punues për rifreskimin dhe ridizajnimin e webfaqes së Fakultetit të Mjekësisë.....</i>	<i>16</i>
<i>Krijimi i grupit punues për donacione dhe projekte</i>	<i>17</i>
<i>Krijimi i komisionit për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe studentëve të Fakultetit të Mjekësisë</i>	<i>17</i>
<i>Përmirësimi i planprogrameve</i>	<i>18</i>
<i>Funksionalizimi i vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve</i>	<i>19</i>
<i>Fillimi i adresimit të integritetit akademik, duke përfshirë plagjiazmin</i>	<i>19</i>
<i>Participimi i studentëve në procesin mësimor</i>	<i>20</i>
<i>Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimor</i>	<i>20</i>
<i>Rishikimi dhe ripërpilimi i raporteve F1, F2, F3</i>	<i>21</i>
<i>Organizimi i Katedrave në aspektin e funksionalizimit më të mirë të dokumentacionit në Google Drive</i>	<i>21</i>
<i>Riorganizimi i aktiviteteve të stafit administrativ</i>	<i>22</i>
<i>Plani strategjik i zhvillimit të Universitetit të Prishtinës.....</i>	<i>23</i>

<i>Ceremonia e diplomimit të studentëve të Universitetit të Prishtinës</i>	<i>23</i>
AKTIVITETI NË SFERËN PROFESIONALE SHËNDETËSORE	24
<i>Takime pune me Drejtorin ekzekutiv të SHSKUK-së dhe Bordin e SHSKUK</i>	<i>24</i>
<i>Takime pune me Kryetarin dhe anetarët e Këshillit Drejtues, Rektorin dhe Sekretarin e Universitetit të Prishtinës</i>	<i>24</i>
<i>Takime pune me Ministrin e Financave, Prof. Avdullah Hotin lidhur me pagat e stafit akademik, drejtorë të Klinikave</i>	<i>25</i>
<i>Takime pune të Komisionit ndërlidhes të kryetarëve të Bordeve dhe të Komisionit Ndërministror ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, MASHT dhe Rektoratit</i>	<i>25</i>
<i>Takime pune në kuadër të Bordit Nacional për Kontroll të Kancerit (BNKK)</i>	<i>26</i>
<i>Organizimi i edukimit të vazhdueshëm profesional nga Fakulteti i Mjekësisë</i>	<i>27</i>
<i>Pjesëmarrja e Fakultetit të Mjekësisë në Simpoziume dhe Kongrese vendore dhe ndërkombëtare</i>	<i>28</i>
<i>Takime pune me përfaqësues të Komunës së Prishtinës lidhur me objektin e Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, i cili ka ngecur në ndërtim</i>	<i>29</i>
AKTIVITETI NË SFERËN E INFRASTRUKTURËS DHE FINANCAVE	31
SHTOJCAT	32

AKTIVITETI NE SFERËN AKADEMIKE-SHKENCORE

Aktiviteti: Hartimi i strategjisë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020

Përshkrimi i aktivitetit: Me marrjen e rolit të menaxhimit të Fakultetit të Mjekësisë, menaxhmenti i ri ka identifikuar nevojën e hartimit të strategjisë zhvillimore në të cilën do të bazohet zhvillimi i Fakultetit, gjatë periudhës 2016-2020. Kjo strategji është prezantuar para partnerëve ndërkombëtar me ç’rast ka marrë edhe vlerësime të larta.



Strategjia zhvillimore 2016-2020 e Fakultetit të Mjekësisë

Rezultatet e pritshme: Strategjia zhvillimore pritet të rifokusojë dhe facilitojë punën e Fakultetit në përmirësimin e katër aspekteve kyçe:

- *Cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies;*
- *Zhvillimin e kapaciteteve kërkimore;*
- *Infrastrukturën e mësimdhënies dhe punës kërkimore dhe*
- *Ndërkombëtarizimin e Fakultetit të Mjekësisë*

Fakulteti i Mjekësisë, përkatësisht Dekanati, gjithashtu ka dhënë një kontribut substancial në hartimin e strategjisë së gjithëmbarshme të Universitetit të Prishtinës.

Aktiviteti: Hartimi i rregullores së punës së shefave të degëve dhe katedrave

Përshkrimi i aktivitetit: Përpilimi i rregullores që parasheh punën e shefave të degëve, katedrave dhe sekretarëve të katedrave, nga menaxhmenti i ri është cilësuar si një nevojë imediate për të përmirësuar funksionalizimin e Katedrave si dhe për të ngritur efikasitetin dhe llogaridhënien në Fakultetin e Mjekësisë. Deri më tani, rolet e shefave të degëve dhe katedrave, por edhe të sekretarëve të tyre, nuk kanë qenë të specifikuar detajisht. Prandaj, kjo rregullore mundëson një transparencë më të mirë në kryerjen e punëve të përditshme në Fakultet.

Rezultatet e pritshme: Zbatimi në përpikëri i kësaj rregulloreje pritet të ngritë efikasitetin, efektivitetin dhe llogaridhënien në të gjitha instancat menaxhuese të Fakultetit të Mjekësisë. Kjo pritet të rezultojë edhe në satisfaksion më të mirë të stafit dhe studentëve, posaçërisht në aspektin e aktiviteteve të përditshme mësimore dhe administrative në Fakultet.

Aktiviteti: Hartimi i udhëzuesit për punimin e temave të diplomës

Përshkrimi i aktivitetit: Me marrjen e detyrës së re, menaxhmenti identifikoi nevojën urgjente të organizimit të temave të diplomës për studentët e degës së Mjekësisë së Përgjithshme dhe Stomatologjisë. Kjo ishte hera e parë që organizoheshin temat e diplomës në këto dy degë. Prandaj, menaxhmenti gjithashtu identifikoi nevojën e përpilimit të udhëzuesit që do të ndihmonte stafin dhe studentët në të gjitha procedurat që ndërlidhen me temën e diplomës, që nga zgjedhja e temës e deri te përfundimi i saj. Një udhëzues i tillë mungonte në Fakultet, edhe pse me vite të tëra degët tjera (Farmaci, Infermieri, Mami dhe Fizioterapi) organizonin mbrojtjen e temave të diplomës.

Rezultatet e pritshme: Udhëzuesi i temave të diplomës do të ngritë cilësinë e temave të diplomës që dorëzohen nga studentët, duke siguruar kështu një standard minimal që duhet të plotësohet. Gjithashtu, udhëzuesi u ndihmon profesorëve dhe studentëve në aspektet teknike të përpilimit të temës së diplomës.

Aktiviteti: Hartimi i rregullores për studimet Master në Fakultetin e Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Me identifikimin e nevojës për përditësimin e rregullores për Master, Dekanja formoi komisionin i cili përpiloi dhe rifreskoi rregulloren ekzistuese për studimet Master në Fakultetin e Mjekësisë.

Rezultatet e pritshme: Kjo rregullore specifikon më mirë të gjitha aspektet që ndërlidhen me studimet Master në Fakultetin e Mjekësisë.

Aktiviteti: Akreditimi i programeve të Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Në muajin maj, Fakulteti i Mjekësisë iu nënshtrua procesit të vlerësimit nga ana e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Ky vlerësim përmbyllte procesin e akreditimit që kishte filluar nga menaxhmenti i kaluar. Pas konfirmimit të prezantimit të shkëlqyeshëm të vizionit zhvillimor dhe programeve të Fakultetit, ekspertët ndërkombëtarë rekomanduan akreditimin e të gjitha programeve të Fakultetit të Mjekësisë. Këtu përfshihen edhe programi i Doktoraturës që për herë të parë u akreditua për 5 vite si dhe programi i Farmacisë që gjithashtu për herë të parë u akreditua për 5 vite (në krahasim me akreditimet e mëhershme të kushtëzuara). Programi i Mamisë nuk u akreditua për shkak të mungesës së kuadrit nga profili i Mamisë, mungesë kjo e evidente jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet e rajonit.

Duke u bazuar në prezantimin dhe vizionin e menaxhmentit për zhvillimin e Fakultetit të Mjekësisë, ekspertët ndërkombëtarë gjithashtu ***për herë të parë rekomanduan pavarësimin e Fakultetit të Mjekësisë*** me qëllim të facilitimit të funksionalizimit më të mirë të tij dhe përmbylljes së vizionit zhvillimor, në linjë me praktikën evropiane të edukimit mjekësor.

Rezultatet e pritshme: Procesi i akreditimit pritet të rezultojë në efekte pozitive për Fakultetin e Mjekësisë, pasi që do të merren parasysh dhe adresohen rekomandimet që do të rezultojnë në përmirësime konkrete në Fakultet.

Aktiviteti: *Themelimi i trupit këshillëdhënës të Fakultetit të Mjekësisë*

Përshkrimi i aktivitetit: Me datën 29 qershor 2016, bazuar në Rregulloren për themelimin dhe funksionimin e Trupave Këshillëdhënëse (TK) të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", u themelua trupa këshillëdhënëse e Fakultetit të Mjekësisë.



Anëtarët e TK-së së Fakultetit të Mjekësisë janë përfaqësues nga odat profesionale, institucionet publike dhe private, të cilat operojnë fushat përkatëse të ndërlidhura me programet ekzistuese të kësaj njësie akademike si:

Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK), Oda e Stomatologëve të Kosovës (OSK), Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK), Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës, Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK), Mjekësia Familjare, Shërbimi Spitalor, Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK), Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHPK), Kompania Trefarm dhe Asociacioni i Institucioneve Shëndetësore Private. Kryetar i TK-së u zgjodh **Dr. Talat Gjinolli**, përfaqësues i Asociacionit të Institucioneve Shëndetësore Private.

Aktiviteti: *Vazhdimi i ndërtimit të kredibilitetit të Fakultetit të Mjekësisë në aspektin e pranimi të studentëve*

Përshkrimi i aktivitetit: Procesi i pranimi të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë, si proces i cili historikisht ka kaluar nëpër faza të ndryshme sensitive, është organizuar nga menaxhmenti i ri duke respektuar në përpikëri udhëzimet dhe konkursin e shpallur nga Rektorati, si dhe duke respektuar rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Në kuadër të aktiviteteve të drejtuara në ngritjen e integritetit të provimit pranues, gjithashtu u dizajnuar formulari i ruajtjes së konfidencialitetit për të gjithë anëtarët

e komisionit të provimit pranues. Ky formular pastaj gjithashtu u modifikua për përdorim edhe nga të gjitha komisionet e Fakultetit të Mjekësisë.

Rezultatet e pritshme: Përmbyllja e suksesshme e procesit të pranimit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë për vitin akademik 2016/2017, vazhdon të ndërtojë kredibilitetin dhe reputacionin e Fakultetit të Mjekësisë. Kjo siguron pranimin e studentëve më të mirë dhe përfundimisht siguron profesionist më të mirë shëndetësorë.



Aktiviteti: *Përmbyllja e procesit të zgjedhjes dhe rizgjedhjes së stafit akademik nga konkursi 2015, si dhe zgjedhjes së stafit të angazhuar për vitin akademik 2016/2017*

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmenti i ri ka përcjellur fazën finale të përfundimit të zgjedhjes dhe rizgjedhjes së stafit akademik nga konkursi 2015. Ky proces është përmbyllur kryesisht me sukses. Gjithashtu kemi organizuar zgjedhjen e stafit të angazhuar për vitin 2016-2017. Gjatë këtyre proceseve, janë identifikuar problemet, të cilat synojmë t'i evitojmë ose parandalojmë në konkurset e ardhshme. Si rezultat i kësaj, Dekanja e Fakultetit ka krijuar një komision, i cili do të përpilojë udhëzimet që ndërlidhen me çështjet specifike të Fakultetit të Mjekësisë që duhet konsideruar.

Rezultatet e pritshme: Identifikimi i çështjeve, të cilat synojmë t'i evitojmë ose parandalojmë në konkurset e ardhshme, do të sigurojë një përzgjedhje më efektive dhe transparente të stafit akademik në konkurset e ardhshme. Kjo do të ndikojë pozitivisht në ndërtimin e mëtutjeshëm të reputacionit të Fakultetit të Mjekësisë, si dhe rezultate më të mira mësimore dhe kërkimore, duke siguruar staf sa më të kualifikuar.

Aktiviteti: *Databazat e rekomanduara për publikime shkencore të stafit të Fakultetit të Mjekësisë*

Përshkrimi i aktivitetit: Me rastin e iniciativës së Rektoratit të Universitetit të Prishtinës për të hartuar një listë të databazave të rekomanduara për publikime shkencore, menaxhmenti i Fakultetit të Mjekësisë, pas konsultimit me stafin akademik të Fakultetit të Mjekësisë propozoi që, (përveç databazës Web of Science dmth Thomson Reuters) gjithashtu të vlejë databazat: Pubmed, Scopus dhe Scimago (që bazohet në Scopus), të jenë databazat e rekomanduara për publikim të punime shkencore nga ana stafit të FM. Këto databaza u konsultuan dhe morën edhe aprovimin e Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë.

Rezultatet e pritshme: Specifikimi i databazave të rekomanduara për publikime shkencore pritet që të mbështesë stafin akademik në procesin e identifikimit të revistave shkencore prestigjioze për të publikuar. Gjithashtu, një specifikim i tillë gjithashtu do të parandalojë publikimin e artikujve shkencorë në revista të dyshimta dhe kështu do të ketë efekte pozitive në integritetin akademik.

Aktiviteti: *Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë*

Përshkrimi i aktivitetit: Siç është specifikuar edhe në strategjinë zhvillimore, ndërkombëtarizimi i Fakultetit të s është një nga prioritetet kyçe të menaxhmentit të ri. Në këtë aspekt, menaxhmenti i ri ka realizuar këto aktivitete konkrete:

- Krijimi i Bordit Ndërkombëtar Këshillues të Nderit (Prof. Bob Djevan, Prof. Margarethe Geiger- Vienna Medical University, Austri; Prof. Alan Schned-Geissel School of Medicine, Dartmouth SHBA; Prof. Jeniffer Goldman, PharmD-MCPHSU, SHBA; Prof. David Trost-New York Presbyterian Hospital, Cornel University (SHBA); Prof. Jeff Hughes-Curtin University in Australia etj).
- Në prill të vitit 2016 Dekanati organizoi përzgjedhjen e kandidatit për shkëmbimin studentor me Geisel School of Medicine. Në kuadër të këtyre aktiviteteve, për herë të parë që nga bashkëpunimi 15 vjeçar në fushën e shkëmbimit të studentëve me këtë Universitet prestigjioz, Dekanati organizoi poentifikimin e detajuar të kandidatëve gjatë intervistimit të tyre. Kjo rezultoi në një proces transparent që në të njëjtën kohë siguroi edhe përzgjedhjen e

kandidatit më të mirë. Për këtë proces të përzgjedhjes Dekanati u vlerësua lartë nga drejtuesit e Geisel School of Medicine. Format i dizajnuar me këtë rast, do t'i shërbejë Fakultetit të Mjekësisë në të ardhmen për të bërë përzgjedhjen e studentëve gjatë shkëmbimeve ndërkombëtare.

- Inicimi i bashkëpunimit me Universitetin e Derbit (Angli), Universitetin e Lyonit (France), Universitetit Istinye (Turqi), Universitetit Linkopin (Suedi), Universitetit Curtin (Australi), Universitetit St. Vincent (Irland), University (SHBA), Columbia University (SHBA), Fakultetit të Shëndetësisë/Universiteti Keele, Staffordshire, Mbretëria e Bashkuar.
- Zgjerimi i bashkëpunimit me Geisel School of Medicine (SHBA)
- Vizita në Geisel School of Medicine (SHBA)
- Këshillimi me diasporën shqiptare që punon në Universitete ndërkombëtare dhe sektorin shëndetësorë në vende të zhvilluara
- Takime të ndryshme me ambasadorë dhe përfaqësues të ambasadave (SHBA, Francës, Austrisë, Turqisë), donatorët ndërkombëtarë të fokusuar në programe të edukimit (p.sh. BE, USAID etj.), si dhe me ekspertë ndërkombëtar



Vizite pune Fakultetit të Mjekësisë-Geisel të Dartmouth University në SHBA.



Takim me Dekanin Prof. Duane Compton




Takimi me ekspertë ndërkombëtarë nga New York Presbyterian Hospital (SHBA), Neurology& Neurosurgery National Institute (Mexico), San Rafael Hospital Colombia (Mexico) dhe Praga (Republika Çeke).



Takim me përfaqësues të Universitetit Mjekësor Istinye, Stamboll, Turqi



Takim i Dekanes së Fakultetit të Mjekësisë, Prof. Dr. Suzana Manxhuka-Kërliu me Prof. Val Was, Profesor Emeritus i Edukimit Mjekësor, të Fakultetit të Shëndetësisë/Universiteti Keele, Staffordshire, Mbretëria e Bashkuar.



Takim me Univ. Prof. Dr. Bob Djavan. Universiteti Mjekësor i Vjenës, Austri.



Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë Prof. Dr. Suzana Manxhuka-Kerliu priti dr. Guido Pfeffer Chefartz Anästhesie und Schmerztherapi Rozenheim Germany. Takimi ishte miqësor si dhe u biseduan sferat e bashkëpunimit akademik, arsimor, edukativ dhe profesional në mes dy institucioneve

Gjatë konferencës së 11-të ndërkombëtare 'Mësimi i vazhdueshëm në Farmaci', që u organizua në Split, Korrik 2016, Prodekani për çështje akademike, Prof Ass Dr Kreshnik Hoti u takua me Mike Rouse, Drejtor i Shërbimeve Ndërkombëtare në Accreditation Council for Pharmacy Education (ACPE) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Gjatë takimit u bisedua për mundësitë e avancimit të programit të Farmacisë sipas standardeve amerikane si dhe u diskutua mundësia e certifikimit nga ACPE.





Fakulteti i Mjekësisë së bashku me Rektoratin e UP-së, gjithashtu ka mbështetur organizimin e asamblesë vjetore të Asociacionit të Studentëve të Mjekësisë së Evropës (EMSA), që është organizuar nga EMSA-Kosova. Ky aktivitet është organizuar për herët të parë në një nga vendet e rajonit.

Siç është cekur edhe në strategjinë zhvillimore, për të arritur ndërkombëtarizimin e FM, menaxhmenti i FM ka planifikuar angazhimin aktiv të alumnit kosovar që punon në institucione ndërkombëtare dhe diasporën shqiptare që punon në Universitete ndërkombëtare dhe sektorin shëndetësorë. Plani është që të krijohen rolet e Profesorëve Vizitorë dhe Profesorëve të Jashtëm (Adjunct) në FM dhe kjo do të ngritë angazhimin aktiv të ekspertëve ndërkombëtarë në FM. Në këtë aspekt, Fakulteti planifikon të organizojë vizita mujore, ligjërata dhe punëtori nga alumnit ndërkombëtar dhe ekspertët akademikë dhe shëndetësorë të diasporës.

Rezultatet e pritshme: Ndërkombëtarizimi i mëtutjeshëm i Fakultetit të Mjekësisë pritet që të ngritë në mënyrë sinjifikante aktivitetet mësimore dhe kërkimore të stafit tonë akademik dhe studentëve në linjë me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Aktivitetet e mësipërme gjithashtu mundësojnë shkëmbimin më të lehtë të studentëve në mënyrë që të kenë mundësi më të mira për t'u njohur me praktikatat ndërkombëtare.

Aktiviteti: Marrëveshjet e bashkëpunimit

Përshkrimi i aktivitetit: Në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare dhe atyre lokale, menaxhmenti i ri gjatë kësaj periudhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Derbit. Kjo marrëveshje është e fokusuar në lëminë e infermierisë dhe përfshinë shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve në lëminë e infermierisë, aspektin kërkimor, mbështetjen në dizajnimin e kurikullës si dhe bashkëpunimin në aspektin e e-learning dhe mësimin nga distanca. Momentalisht, gjithashtu jemi në proces të nënshkrimit të marrëveshjes me Universitetin e Lyon-it (France), në fushën e Mjekësisë.

Gjithashtu, me qëllim të përmirësimit të kushteve të studimit, në aspektin e realizimit të anës praktike, është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit me kompaninë farmaceutike Trefarm, në Kosovë.



Detaje nga nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me kompaninë farmaceutike Trefarm.

Rezultatet e pritshme: Marrëveshjet e mësipërme pritet të rezultojnë në përmirësime konkrete në mësimdhënien dhe mësimnxënien në Fakultetin e Mjekësisë, përkatësisht degët Infermieri dhe Farmaci



Detaje nga praktika e studentëve të Farmacisë në Trefarm

Aktiviteti: Rifreskimi i Katedrave

Përshkrimi i aktivitetit: Me qëllim të funksionalizimit më të mirë të katedrës së Anatomisë Patologjike dhe asaj të Histologjisë dhe duke marrë parasysh afërsinë e këtyre fushave, është bërë shkrirja e këtyre dy katedrave në një katedër të vetme. Gjithashtu, janë krijuar katër katedra në degën e Farmacisë, degë kjo e cila nuk kishte asnjë katedër të krijuar dhe si pasojë e kishte shumë të vështirë jo vetëm organizimin dhe mbarëvajtjen e mësimit por dhe zhvillimin strategjik të kësaj dege në linjë me praktikant ndërkombëtare.

Rezultatet e pritshme: Katedrat e rifreskuara dhe ato të krijuara do të rezultojnë në një organizim më të mirë të punës dhe një profilizim dhe zhvillim më dinamik të këtyre lëmvive përkatëse.

Aktiviteti: Krijimi i laboratorit e-lab

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmenti ka marrë iniciativën e krijimit të e-lab. Kjo është duke u realizuar në laboratorin e shfrytëzuar deri më tani nga dega e Infermierisë, në kuadër të projektit Tempus. Siç edhe është cekur në strategjinë zhvillimore të Fakultetit, e-lab është duke u dizajnuar në mënyrë që të integrojë teknologjitë moderne që synojnë facilitimin e edukimit mjekësorë. Në këtë aspekt, do të përdoren softuerë që asistojnë edukimin, e-learning dhe module të edukimit nga distanca. Deri më tani janë porositur softuerë që mundësojnë mësimin nga distanca, smart-boards, që facilitojnë interaksionin gjatë procesit mësimor, si dhe softuerë për verifikimin e plagjiaturës. Ky e-lab do të zhvillohet vazhdimisht dhe do të jetë në dispozicion për të gjithë studentët e Fakultetit të Mjekësisë, si dhe do të shërbejë për mësimdhënie për lëndët që shfrytëzojnë një teknologji të tillë.

Rezultatet e pritshme: E-lab do të ofrojë mundësinë për të:

- shfrytëzuar softuerë të ndryshëm që do të asistojnë mësimin e studentëve dhe performancën e tyre akademike.
- shfrytëzuar softverin kundër plagjiarizmit për të ruajtur integritetin akademik.
- stimuluar angazhimin e studentëve dhe interaksionin në mësimnxënie

- ofruar material mësimor interaktiv
- qasur në mënyrë më efektive dhe më të lehtë në databaza të ndryshme
- integruar më mirë alumnit tonë që punojnë në institucione ndërkombëtare
- ofruar trajnim të vazhdueshëm të stafit tonë akademik në komponente të ndryshme të mësimdhënies dhe vlerësimit.

Gjithashtu, e-lab do të mbështesë procesin e fillimit të ndërtimit të komponenteve online të lëndëve në programe të ndryshme të FM dhe kështu arrihet mbështetja konkrete e facilitimit të bashkëpunimit me staf akademik dhe Universitete ndërkombëtare

Aktiviteti: Krijimi i Qendrës Informative të Barnave (QIB)

Përshkrimi i aktivitetit: Fakulteti i Mjekësisë ka marrë iniciativën e themelimit të Qendrës Informative të Barnave (QIB). Kjo është e para QIB në Kosovë dhe misioni parësor i kësaj qendre është që të sigurohet përdorimi racional i barnave, minimizimi i problemeve nga barnat dhe reduktimi i pranimeve në spital si rezultat i përdorimit jo të drejtë të barnave. Deri më tani, Dekanati ka realizuar këto aktivitete që ndërlidhen me krijimin e QIB:

- ka krijuar grupin punues për themelimin e QIB
- ka dizajnuar projekt propozimin dhe buxhetin për themelimin e QIB
- ka hartuar kohëzgjatjen e krijimit të QIB
- ka identifikuar hapësirën për vendosjen e QIB
- është takuar me donatorë nga industria farmaceutike që janë shprehur të gatshëm për mbështetjen e kësaj qendre
- është takuar më drejtorin e SHSKUK-së dhe ka marrë pëlqimin për themelimin e QIB

Për momentin është duke u pritur akti final i aprovimit të themelimit të QIB si institut në kuadër të QKUK-së.


Rezultatet e pritshme: QIB do të ndikojë pozitivisht në avancimin e aktiviteteve që ndërlidhen me mësimnxënien dhe mësimdhënien rreth barnave. Gjithashtu, do të sigurojë një shfrytëzim më të mirë të ekspertizës që për momentin është në dispozicion në Degën e

Farmacisë dhe Katedrën e Farmakologjisë. QIB do të përmirësojë bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet Fakultetit dhe Klinikave të QKUK, do të përmirësoj sigurinë dhe mirëqenien e pacientëve rreth barnave, si dhe do të mbështesë klinikistët në QKUK në lidhje me informimin profesional dhe të pavarur mbi barnat

Aktiviteti: Krijimi i grupit punues për rifreskimin dhe ridizajnimin e webfaqes së Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmenti i ri ka identifikuar nevojën e komunikimit më të mirë me stafin akademik dhe studentët në Fakultet. Në këtë aspekt, roli i webfaqes së Fakultetit është esencial. Prandaj, është krijuar grupi punues i cili në bashkëpunim me personelin e IT-së nga Rektorati ka ridizajnuar webfaqen e Fakultetit të Mjekësisë, si dhe siguron rifreskimin e vazhdueshëm të webfaqes (Fig 5).

Rezultatet e pritshme: Ridizajnimi, rifreskimi dhe mirëmbajtja e vazhduar e webfaqes së Fakultetit do të ndikojë pozitivisht në reputacionin e Fakultetit, si dhe do të lehtësojë komunikimin mes menaxhmentit, stafit akademik dhe studentëve të Fakultetit.



Aktiviteti: Krijimi i grupit punues për donacione dhe projekte

Përshkrimi i aktivitetit: Me ardhjen në detyrë, menaxhmenti ka identifikuar nevojën esenciale që Fakulteti i Mjekësisë të sigurojë donacione dhe financim nga donatorë dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare. Në këtë aspekt, është identifikuar nevoja e intensifikimit të aktiviteteve që ndërlidhen me aplikimin e stafit akademik për grante të ndryshme kërkimore, mësimore apo zhvillimore. Me këtë rast është formuar një grup punues që do të identifikojë dhe informojë stafin akademik për mundësitë e granteve që ofrohen nga donatorët e ndryshëm. Gjithashtu, anëtarët e këtij grupi janë dërguar në trajnim, të organizuar në Prishtinë nga Universiteti i Arizonës (SHBA). Ky trajnim përfshinte aspektet e zhvillimit të aftësive në shkrimin dhe aplikimin e granteve nga stafi akademik. Funkcionalizimi dhe aftësimi i plotë i këtij grupi është një proces gradual dhe pritet që funksionalizimi dhe rezultatet konkrete të këtij grupi të shihen në gjysmën e parë të vitit 2017.

Rezultatet e pritshme: Tërheqja e fondeve për zhvillim të Fakultetit të Mjekësisë, duke përfshirë ngritjen e aktivitetit kërkimor dhe numrit të publikimeve, si rezultatet i përmirësimit të kushteve me rastin e marrjes së granteve përkatëse.

Aktiviteti: Krijimi i komisionit për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe studentëve të Fakultetit të Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Dekanati ka marrë iniciativën e vlerësimit të performancës së stafit akademik dhe studentëve të Fakultetit me qëllim të njohjes dhe stimulimit të stafit dhe studentëve që dëshmojnë performancë të shkëlqyeshme gjatë vitit akademik. Me këtë rast, Dekanja formoi komisionin i cili pas takimeve gjatë shtatorit 2016 propozoi krijimin e katër mirënjohjeve:

- *Mirënjohje për performancë të shkëlqyeshme në punë hulumtuese shkencore (kategoritë: Profesor dhe Asistent)*
- *Mirënjohje për performancë të shkëlqyeshme në mësimdhënie (kategoritë: Profesor dhe Asistent)*

- *Mirënjohje: student i dalluar i Fakultetit të Mjekësisë (dega: X) për vitin akademik XY*
- *Mirënjohje: student i dalluar i Fakultetit të Mjekësisë (dega: X) i gjeneratës XY së të diplomuarve (kjo mirënjohje të jepet me rastin e ceremonisë së diplomimit)*

Përzgjedhja e kandidateve është propozuar të jetë sipas sistemit të nominimit dhe/ose aplikimit të hapur, që pasohet nga verifikimi dhe përzgjedhja nga komisioni. Gjithashtu, është propozuar që mirënjohja për punë hulumtuese shkencore në Fakultetin e Mjekësisë të emërtohet: ***Mirënjohja Prof Dr Musa Haxhiu për punë hulumtuese shkencore.***

Mirënjohjet e Fakultetit të Mjekësisë jepen me rastin e përfundimit të çdo viti akademik, d.m.th. në qershor.

Rezultatet e pritshme: Njohja dhe stimulimi i stafit akademik dhe studentëve për performancën e tyre akademike, mësimdhënëse apo hulumtuese shkencore, do të rezultojë në ngritje të cilësisë së mësimdhënies si dhe potencialisht mund të ngritë numrin e publikimeve nga Fakulteti i Mjekësisë. Mirënjohjet ndaj studentëve, përveç njohjes dhe identifikimit të studentëve të dalluar, do të stimulojë studentët e FM në procesin e mësimnxënies.

Aktiviteti: Përmirësimi i planprogrameve

Përshkrimi i aktivitetit: Menaxhmenti i ri, në bashkëpunim me administratën e Fakultetit, ka identifikuar një sërë gabimesh teknike apo matematikore në planprogramet e mëhershme të Fakultetit të Mjekësisë, kryesisht planprogramet e vitit 2007, 2010 dhe 2013. Si pasojë, studentët e diplomuar në këtë Fakultet hasnin në vështirësi me rastin e aplikimit për punë ose për vazhdim studimesh jashtë shtetit. Gjithashtu, administrata ngarkohej shumë duke u munduar të bëjë korrigjime përkatëse. Këto gabime nuk ishin adresuar më herët në nivel të lartë. Pas konsultimit me Zyrën për Zhvillim Akademik në nivel të Rektoratit, këto gabime u përmirësuan. Kjo ishte një punë intensive dy mujore me ç'rast u bë një koordinim i punëve mes Koordinatorit për Zhvillim Akademik, Prodekanit për Çështje Akademike dhe shefave të

degëve përkatëse. Këto përmirësime, pastaj, u rishikuan nga komisioni i studimeve, si dhe Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë.

Rezultatet e pritshme: Adresimi i problemeve të akumuluar ndër vite me planprograme, do të rezultojë me ndërtim të reputacionit të Fakultetit të Mjekësisë, si dhe do t'u lehtësojë studentëve tonë ndërlidhjet me Universitetet apo institucionet e ndryshme shëndetësore ndërkombëtare. Gjithashtu, kjo do të ndikojë në rritje të satisfaksionit të palëve të treta që kërkojnë planprograme nga Fakulteti, si dhe ulje të barrës administrative me rastin e kthimeve të planprogrameve për përmirësim nga institucionet ndërkombëtare.

Aktiviteti: *Funksionalizimi i vlerësimit të vazhdueshëm të studentëve*

Përshkrimi i aktivitetit: Në kuadër të adresimit të strategjisë zhvillimore 2016-2020 të Fakultetit të Mjekësisë, ka filluar edhe zbatimi më i përpiktë i vlerësimit të vazhdueshëm. Në këtë aspekt, është dizajnuar formulari për raportimin e vlerësimit të vazhdueshëm, si dhe do të organizohen workshope (punëtori) që do të mbështesin stafin akademik në realizimin e këtyre vlerësimeve. Në kuadër të kësaj iniciative, gjithashtu janë specifikuar çështjet që ndërlidhen me integritetin akademik të procesit të vlerësimeve në Fakultetin e Mjekësisë.

Rezultatet e pritshme: Kjo iniciativë pritet të rezultojë në efekte pozitive në procesin e vlerësimit të studentëve dhe përfundimisht të kontribuojë drejt strategjisë së ndërprerjes së praktikës së deritanishme ku studentët dëgjojnë ligjëratat të viteve vijuese, ndërsa mësojnë dhe hyjnë në provime të viteve paraprake. Kjo do të ngritë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe do të kontribuojë në arritjen e standardeve ndërkombëtare nga ana e Fakultetit të Mjekësisë.

Aktiviteti: *Fillimi i adresimit të integritetit akademik, duke përfshirë plagjiarizmin*

Përshkrimi i aktivitetit: Në kuadër të adresimit të strategjisë zhvillimore 2016-2020, gjithashtu kanë filluar aktivitetet që ndërlidhen me përmirësimin e integritetit akademik, më saktësisht integritetit themelorë akademik, vlerësimit të drejtë të studentëve, regjistrimit të notimit të studentëve dhe moderimit të vlerësimeve. Këtu përfshihet edhe fillimi i adresimit

të çështjes së plagjiarizmit. Në këtë aspekt, janë dizajnuar formularët që asistojnë në këtë proces, është informuar stafi akademik dhe fakulteti ka porositur softuer kompjuterik që do t'u mundësojë stafit dhe studentëve kontrollin e plagjiaturës para dhe gjatë dorëzimit të punës kërkimore të studentëve. Fillimisht, është menduar që në këtë proces të përfshihet kontrolli dhe monitorimi i plagjiarizmit me rastin e dorëzimit të temave të diplomës në Fakultetin e Mjekësisë. Menaxhmenti e parasheh këtë si proces gradual që do të implementohet plotësisht, sipas praktikave ndërkombëtare, brenda periudhës katërvjeçare siç parashihet në strategjinë zhvillimore të Fakultetit.

Rezultatet e pritshme: Adresimi i integritetit akademik do të afrojë Fakultetin e Mjekësisë me praktikat ndërkombëtare, do të ndikojë pozitivisht në reputacionin e Fakultetit dhe do të ngritë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në Fakultetin e Mjekësisë.

Aktiviteti: *Participimi i studentëve në procesin mësimor*

Përshkrimi i aktivitetit: Në kuadër të aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë bërë takime të veçanta me shefa të katedrave si dhe takime me studentë për të ngritur vetëdijen në aspektin e participimit në ligjërata. Gjithashtu, për stafin akademik janë dizajnuar formularë që lehtësojnë regjistrimin dhe monitorimin e participimit të studentëve.

Rezultatet e pritshme: Në krahasim me vitet e kaluara, vërehet një ngritje sinjifikante e participimit të studentëve në ligjërata. Dekanati është në proces të krahasimit konkret të këtyre shifrave, duke u bazuar në librat amzë të regjistrimit të ligjëratave.

Aktiviteti: *Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimor*

Përshkrimi i aktivitetit: Monitorimi i procesit mësimor është kryer me sukses gjatë periudhës mars-dhjetor 2016. Gjithashtu, është identifikuar nevoja e ridizajnit të monitorimit dhe raportimit të procesit mësimorë me ç'rast janë deleguar dhe specifikuar detyrat edhe tek shefat e degëve, katedrave dhe sekretarëve përkatës. Në këtë aspekt gjithashtu, janë ridizajnuar edhe formularët e raportimit për të mbështetur këtë proces.

Rezultatet e pritshme: Monitorimi dhe raportimi i procesit mësimor ka qenë i suksesshëm gjatë kësaj periudhe. Në baza mujore është identifikuar dhe proceduar stafi që nuk ka mbajtur mësimin. Ridizajnimi i procesit të raportimit të mësimin ka filluar të rezultojë në një përmbyllje më efektive të aktiviteteve mujore të raportimit të procesit mësimor. Kjo është duke ndodhur falë aktivizimit të të gjitha strukturave menaxhuese të Fakultetit, duke përfshirë Dekanatin, shefat e degëve, katedrave dhe sekretarëve përkatës.

Aktiviteti: Rishikimi dhe ripërpilimi i raporteve F1, F2, F3

Përshkrimi i aktivitetit: Pas identifikimit të problemeve të shumta në aspektin e raportimit të orëve në Fakultetin e Mjekësisë, me fillimin e vitit akademik 2016/2017 menaxhmenti ka marrë për detyrë rishikimin dhe ripërpilimin e të gjitha raporteve F1, F2 dhe F3 të stafit akademik. Kjo është realizuar brenda një periudhe një mujore (shtator 2016) ku thelbësisht janë rishikuar të gjitha Katedrat. Gjatë këtij procesi, janë konsultuar individualisht shefat e katedrave përkatëse me ç'rast janë finalizuar raportet e orëve të stafit akademik për vitin akademik 2016/2017.

Rezultatet e pritshme: Rishikimi dhe ripërpilimi i raporteve të orëve F1, F2 dhe F3 siguron një pasqyre më të saktë të angazhimit të stafit. Kjo është esenciale dhe siguron një planifikim më të mirë kadrovik, përkatësisht zhvillim dhe planifikim kadrovik më afatgjatë të Fakultetit të Mjekësisë.

Aktiviteti: Organizimi i Katedrave në aspektin e funksionalizimit më të mirë të dokumentacionit në Google Drive

Përshkrimi i aktivitetit: Organizimi administrativ i katedrave të Fakultetit ka qenë vazhdimisht sfidues për shkak të madhësisë së Fakultetit të Mjekësisë dhe numrit të katedrave. Prandaj, ishte e domosdoshme që kjo çështje të rishikohej në mënyrë që të sigurohet një mbarëvajtje më efiçente e punëve të katedrave, si dhe një komunikim më efektiv ndërmjet Dekanatis, Koordinatorit për Zhvillim Akademik, Shefave të Degëve, Shefave të Katedrave, si dhe Sekretarëve të Degëve dhe Katedrave përkatëse. Për të

adresuar këtë, duke shfrytëzuar google-drive, janë krijuar folderet individualë për çdo katedër e që janë të qasshme online nga cilado pikë, nga sekretarët dhe shefat përkatës të Katedrave.

Rezultatet e pritshme: Aktivitetet e mësipërme mundësojnë një komunikim më të mirë si dhe një rifreskim të vazhdueshëm të dokumentacionit që kërkohet. Kjo pastaj, lehtëson proceset si: raportimi i orëve, rizgjedhja e stafit, kontratat e stafit, procesin e akreditimit etj.


Aktiviteti: Riorganizimi i aktiviteteve të stafit administrativ

Përshkrimi i aktivitetit: Një ndër sfidat kyçe administrative të Fakultetit të Mjekësisë vazhdojnë të mbesin çështjet administrative që kanë të bëjnë me shërbimet që ofrohen tek studentët dhe palët e treta. Këtyre sfidave u janë shtuar edhe punët administrative që ndërlidhen me mbrojtjen e temave të diplomës, ndërsa është rritur nevoja e stafit të ri administrativ, posaçërisht duke marrë parasysh pensionimin e stafit të mëhershëm dhe moszëvendësimin e tyre. Për të lehtësuar dhe përmirësuar këtë gjendje, menaxhmenti në bashkëpunim me administratën, ka ridizajnuar mbarëvajtjen e punëve gjatë procesit të dhënies së planprogrameve mësimore, si dhe gjatë procesit të mbrojtjes së temave të diplomës. P.sh. janë caktuar ditët e veçanta për palë, është caktuar orari i mbrojtjes së temave për secilën Degë në mënyrë specifike etj. Ridizajnimi i mbarëvajtjes së punës gjithashtu do të vazhdojë me aspektet tjera administrative që kanë të bëjnë me dhënien e shërbimeve nga ana e Fakultetit të Mjekësisë. Menaxhmenti shpreson që gjatë vitit 2017 do të aprovohen pozita administrative për FM.

Rezultatet e pritshme: Një riorganizim dhe ridizajnim i mbarëvajtjes së punëve administrative do të rezultojë në uljen e barrës administrative, ngritje të efijencës së administratës, si dhe ngritje të satisfaksionit nga ana e palëve të treta.

Aktiviteti: *Plani strategjik i zhvillimit të Universitetit të Prishtinës*

Përshkrimi i aktivitetit: Fakulteti i Mjekësisë dha një kontribut substancial në përpilimin e planit strategjik të zhvillimit të Universitetit të Prishtinës



Rezultatet e pritshme: Implementimi në përpikëri i planit strategjik të Universitetit të Prishtinës/të Fakultetit të Mjekësisë.

Aktiviteti: *Ceremonia e diplomimit të studentëve të Universitetit të Prishtinës*

Përshkrimi i aktivitetit: Fakulteti i Mjekësisë mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të studentëve të tij, ceremoni kjo e organizuar për herë të parë në Universitetin e Prishtinës.



Rezultatet e pritshme: Ceremonia e diplomimit të organizohet edhe më tutje duke avancuar formatin e ceremonisë.

AKTIVITETI NË SFERËN PROFESIONALE SHËNDETËSORE

Aktiviteti: Takime pune me Drejtorin ekzekutiv të SHSKUK-së dhe Bordin e SHSKUK

Përshkrimi aktivitetit: Gjatë takimeve janë diskutuar shumë çështje lidhur me aktivitetet edukative të Fakultetit të Mjekësisë në Klinikat e QKUK-së si:

- uzurpimi i hapësirave të dedikuara për studentët dhe stafin akademik;
- mospërfshirja e farmacistëve si kontribues në kujdesin shëndetësor
- plotësimi i Statutit të QKUK-së nga komisioni i zgjedhur nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë

Rezultatet e pritshme: Te thellohet integrimi i edukimit shëndetësor me kujdesin shëndetësor, duke rezultuar në avancimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në lëndët klinike, që ka për synim ngritjen e kompetencave të të diplomuarve nga Fakulteti i Mjekësisë dhe më tutje ofrimi i një kujdesi më të mirë shëndetësor në Kosovë.

Aktiviteti: Takime pune me Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Drejtues, Rektorin dhe Sekretarin e Universitetit të Prishtinës

Përshkrimi i aktivitetit: Është biseduar lidhur me problemet e kthimit në listën e pagave të stafit akademik, drejtorë të Klinikave, si staf i rregullt dhe kompensimin e pagave të papaguara sipas vendimit të ish rektorit. Pas diskutimeve, u premtua se stafi akademik, drejtorë të Klinikave, do të kthehet në listat e rregullta të pagave dhe do të shihen mundësitë që të bëhet kompensimi i pagave të papaguara, meqë Universiteti nuk posedon këtë buxhet.

Rezultatet e pritshme: Të kuptohet drejt puna e stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, të cilët në të njëjtën kohë ofrojnë shërbime shëndetësore në kuadër të kujdesit terciar shëndetësor.

Aktiviteti: Takime pune me Ministrin e Financave, Prof. Avdullah Hotin lidhur me pagat e stafit akademik, drejtorë të Klinikave

Përshkrimi i aktivitetit: Në këtë takim u diskutua mbi mundësitë financiare të Qeverisë së Kosovës për të mbuluar pagat e realizuara, por të papaguara të stafit akademik të Universitetit të Prishtinës, sipas vendimit të ish rektorit, vendim ky që u anulua nga Gjykata si i padrejtë. Diskutimi u fokusua në pagat e stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, drejtorë të Klinikave të QKUK-së. Ministri Hoti premtoi se do të angazhohet të gjejë mundësinë e pagesës së këtij grupi të profesorëve, drejtorë të Klinikave të QKUK-së.

Rezultatet e pritshme: Ligji mbi pagat, i cili është në proces, të përcaktojë drejt punën e stafit akademik të Fakultetit të Mjekësisë, njëherit punëtorë shëndetësorë të involvuar në kujdesin shëndetësor terciar.

Aktiviteti: Takime pune të Komisionit ndërlidhës të kryetarëve të Bordeve dhe të Komisionit Ndërmintor ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, MASHT dhe Rektoratit

Përshkrimi i aktivitetit: Në kuadër të Komitetit ndërlidhës të kryetarëve të Bordeve janë diskutuar shumë çështje që kanë të bëjnë me punët e bordeve të ndryshme që veprojnë në Ministrinë e Shëndetësisë si: Bordi etiko-profesional, Bordi për edukim specialistik, Bordi për edukim të vazhdueshëm profesional, Bordi për licencim dhe rilicencim, Bordi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve publike shëndetësore dhe Bordi nacional për kontroll të kancerit.

Në kuadër të Komisionit ndërmintor ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, MASHT dhe Rektoratit janë realizuar disa takime pune – punëtori, në të cilat janë diskutuar çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me funksionalizimin më të mirë të edukimit mjekësor të Fakultetit të Mjekësisë me kujdesin shëndetësor, duke u munduar të gjenden modalitete të ndryshme për të përmirësuar integrimin më të mirë të këtyre dy komponentëve të Fakultetit të Mjekësisë dhe QKUK e QSKUK. Po ashtu, janë diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me akreditimin e programeve të ndryshme studimore në Universitetin e Prishtinës, e të cilat kërkojnë licencim të mëtutjeshëm shëndetësor. Prandaj, u kërkua një komunikim më i mirëfilltë ndërmjet institucioneve si Universitetit, Agjencionit të Akreditimit dhe Bordit

Nacional për Cilësi dhe Zyrave të licencimit në MASHT dhe Ministri të Shëndetësisë. Në kuadër të këtyre takimeve u shfaq nevoja e nënshkrimit të Memorandumit të bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë, MASHT dhe Universitetit të Prishtinës për unifikimin e pagave të punëtorëve shëndetësorë të



kujdesit terciar/njëherit staf akademik i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës.

Rezultatet e pritshme: Përfshirja aktive e Fakultetit të Mjekësisë në Bordet e ndryshme, të cilat veprojnë në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, me qëllim të zgjidhjes sa më të mirë të çështjeve të ndryshme që kanë të bëjnë me edukimin pasdiplomik profesional shëndetësor. Të adresohen dhe të zgjidhen problemet e Fakultetit të Mjekësisë, të cilat kanë të bëjnë me të dy ministritë, si atë të shëndetësisë dhe të arsimit.

Aktiviteti: Takime pune në kuadër të Bordit Nacional për Kontroll të Kancerit (BNKK)

Përshkrimi i aktivitetit: Kompletimi i BNKK-së duke përfshirë të gjitha disiplinat e involvuara në menaxhimin e pacientëve me kancer, rishikimi dhe plotësimi i “Programit Nacional për Kontroll të Kancerit”, përcaktimi i prioriteteve të BNKK, implementimi dhe monitorimi i pilot projektit mbi skrinimin e kancerit të qafës së mitrës, monitorimi i projektit Ma-Mo 1&2 për skrinimin e kancerit të gjirit, prezantimi në konferencat ndërkombëtare mbi kancerin si:

- Konferenca e liderëve botërorë mbi kancerin e organizuar nga Unioni Internacional për Kontroll të Kancerit - UICC
- Tryeza e Rrumbullakët mbi kancerin e gjirit e organizuar nga Parlamenti Evropian



Rezultatet e pritshme: Të adresohet problemi i kontrollit të kancerit në nivel nacional, duke avancuar edukimin deridiplomik në sferën e onkologjisë konform trendeve ndërkombëtare. Në këtë drejtim duhet avancuar planprogramin e onkologjisë sipas tendencave bashkëkohore.

Aktiviteti: Organizimi i edukimit të vazhdueshëm profesional nga Fakulteti i Mjekësisë

Përshkrimi i aktivitetit: Në takim me shefa të degëve dhe katedrave u vendos organizimi i ligjëratave nga Fakulteti i Mjekësisë së bashku me Drejtorin arsimor në QKUK, në mënyre që t'i mundësohet edukimi i vazhdueshëm profesional stafit shëndetësor në gjithë Kosovën, që mund të realizohet përmes Qendrës së Telemjekësisë së Kosovës.

Rezultatet e pritshme: Kjo do të mundësonte avancimin e njohurive profesionale konform trendeve bashkëkohore ndërkombëtare dhe njëherit realizimin e pikëve të nevojshme për rilicencim të stafit shëndetësor të Kosovës. Në këtë mënyrë Fakultetit i Mjekësisë rimerr rolin e tij kyç në edukimin pasdiplomik profesional. Realizimi i pikëve (CME) do të bëhet në akordim me Bordin për Edukim të vazhdueshëm profesional në Ministrinë e Shëndetësisë.

Aktiviteti: Pjesëmarrja e Fakultetit të Mjekësisë në Simpoziume dhe Kongrese vendore dhe ndërkombëtare

Përshkrimi i aktivitetit: Fakulteti i Mjekësisë ka marrë pjesë në evenimente të ndryshme profesionale dhe shkencore me karakter ndërkombëtar në Prishtinë, Kosovë dhe jashtë si: Koeln të Gjermanisë, Paris të Francës, Vjenë të Austrisë, Split të Kroacisë etj.



Ceremonia e Hapjes së Simpoziumit të 3^{të} Satelitor të organizuar nga KOMC së bashku me Fondacionin Amerikano-Austriak




Pjesëmarrja ne Kongresin e 23^{te} Evropian te Patologjisë dhe Kongresit te 31^{te} te Akademisë Internacionale të Patologjisë dhe Vizitë Qendrës Universitare Klinike/Institutit të Patologjisë/ Qendër e ekselencës për hulumtime shkencore në Gjermani



Kongresi i XI Nacional i Urologjisë Kosovare me pjesëmarrje ndërkombëtare!



Simpoziumi i VII i Radiologjisë Kosovare



Konferenca e 11^{të} ndërkombëtare 'Mësimi I vazhdueshëm në Farmaci', Split, Korrik 2016

Rezultatet e pritshme: Fakulteti i Mjekësisë do të këtë rol prijës në edukimin e vazhdueshëm profesional duke u shndërruar në një "Qendër të ekselencës". Në këtë drejtim do të përpilohet agjenda e ligjëratave të organizuara nga Fakulteti i Mjekësisë, duke ftuar eksperte nga Evropa, SHBA dhe me gjerë, nga fusha të ndryshme shëndetësore.

Aktiviteti: *Takime pune me përfaqësues të Komunës së Prishtinës lidhur me objektin e Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë, i cili ka ngecur në ndërtim*

Përshkrimi i aktivitetit: Janë realizuar disa takime me përfaqësues të inspektoratit dhe të shëndetësisë të Komunës së Prishtinës për të diskutuar mundësinë e tejkalimit të sfidave deri në përfundimin e ndërtimit te objektit të ri të Fakultetit të Mjekësisë. Në këto takime u

identifikuan problemet dhe u diskutua mbi realizimin sa me të shpejt të këtij ndërtimi, i cili është me prioritet nacional për Kosovën.

Rezultatet e pritshme: Ndërtesa e re e Fakultetit të Mjekësisë të përfundojë në kohën e paraparë, në mënyre që të plotësojë nevojat e Fakultetit të Mjekësisë.

AKTIVITETI NË SFERËN E INFRASTRUKTURËS DHE FINANCAVE

Pas miratimit të Ligjit për buxhetin e vitit 2016, si dhe njoftimit nga Departamenti i Buxhetit i Ministrisë së Financave mbi ndarjet përfundimtare, menaxhmenti i UP-së e ka bërë ndarjen e buxhetit të aprovuar sipas kërkesave dhe nevojave imediate të njësive akademike, si dhe ndarjen e shpenzimeve fikse në nivel të Universitetit. Ky propozim i menaxhmentit për ndarjen e buxhetit është miratuar nga Këshilli Drejtues i UP-së

Duke u bazuar në ligjet e lartcekura, Buxheti i lejuar i Fakultetit të Mjekësisë për vitin 2016 është si në tabelën vijuese:

Kategoritë ekonomike	
Mallra dhe shërbime	65,000.00 €
Investimet Kapitale	
Pajisje laboratorike	45,000.00 €
Mjete konkretizimi	45,000.00 €
Renovimi i objekteve	40,000.00 €
Ndërtimi i objektit të ri të dekanatit	400,000.00 €
Totali:	595,000.00 €

Prishtinë, janar 2017

Prof. Dr. Suzana Manxhuka-Kërliu

D e k a n e

Prof. Ass. Dr. Kreshnik Hoti

Prodekan për çështje akademike

Prof. Assoc. Dr. Gloria Staka

Prodekane për çështje financiare

Prof. Ass. Dr. Ibrahim Rudhani

Prodekan për shëndetësi

SHTOJCAT

1. Strategjia Zhvillimore e Fakultetit të Mjekësisë
2. Rregullorja e Punës së Shefave të Katedrave dhe Shefave të Degëve në Fakultetin e Mjekësisë
3. Rregullore për studimet master në Fakultetin e Mjekësisë
4. Deklaratë e Konfidencialitetit (për Dartmouth)
5. Deklaratë e Konfidencialitetit (për Komisione të Fakultetit të Mjekësisë)
6. Udhëzuesi për intervistim të kandidatëve
7. Udhëzues për hartimin e punimit të temës së diplomës për studime themelore
8. Draft-projekt propozim për Qendrën Informativë të Barnave
9. Raporti i vlerësimit të vazdhueshëm të studentëve
10. Formulari i monitorimit të vlerësimit të studentëve



Fakulteti i Mjekësisë
Universiteti i Prishtinës

STRATEGJIA ZHVILLIMORE

2016-2020

Përmbledhje e shkurtër



Shtator, 2016

Përmbledhje e shkurtër

Ky dokument përshkruan draft-strategjinë zhvillimore të Fakultetit të Mjekësisë për periudhën 2016-2020.

Me një staf prej përafërsisht 300 Profesorëve dhe Asistentëve, Fakulteti i Mjekësisë është një nga njësitë më të mëdha të Universitetit të Prishtinës dhe përbëhet nga gjashtë programe studimore: Mjekësia e Përgjithshme, Stomatologjia, Farmacia, Fizioterapia, Infermiera dhe Mamia. Gjatë vitit akademik 2015/16 Fakulteti i Mjekësisë kishte gjithsej 4126 studentëve të nacionaliteteve të ndryshme ndërsa përafërsisht 400 student diplomojnë nga ky Fakultet çdo vit. Fakulteti i Mjekësisë është një nga njësitë më prestigjioze të Universitetit të Prishtinës me një proces mjaft kompetitiv të pranimit të studentve (çdo vit përafërsisht 2500 studentë aplikojnë për rreth 350 vende të lira). Ky proces kompetitiv i pranimit të studentëve rezulton në pranim të studentëve të cilësisë së lartë në Fakultetin e Mjekësisë. Gjithashtu, vlen të theksohet se të diplomuarit (alumni) e Fakultetit të Mjekësisë, janë profesionistë mjaft të suksesshëm jo vetëm në Kosovë por edhe ndërkombëtarisht.

Strategjia zhvillimore 2016-2020 vendos prioritetet kyqe të cilat do të drejtojnë zhvillimin afat-shkurt dhe afat-mesëm të Fakultetit dhe gjithashtu do të shtrojnë bazën për një zhvillim të qëndrueshëm afat-gjatë të Fakultetit. Këto prioritete janë të bazuara rreth katër fushave kyqe zhvillimore: *cilësia e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes, zhvillimi i kapaciteteve hulumtuese, infrastruktura e mësimdhënjes dhe punës kërkimore dhe ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë*. Zhvillimi i cilësisë së mësimdhënjes dhe mësimnxënjes është i fokusuar rreth përmirësimit të metodave tradicionale të mësimdhënjes dhe vlerësimit të studentëve, integriteti akademik si dhe sjellja e ideve inovative që do të mbështesin zhvillimin afat-gjatë të cilësisë së mësimdhënjes dhe mësimnxënjes. Në këtë aspekt, ky dokument shtjellon themelimin e e-labororit, qendrës për aftësim klinik, rolin të facilitatorit klinik dhe qendrës informative të barnave.

Përmbledhja ekzekutive e strategjisë zhvillimore 2016-2020 gjithashtu shkurtimisht thekson përmirësimin e kapaciteteve hulumtuese duke caktuar kështu edhe objektivat që duhet arritur gjatë kësaj periudhe kohore. Gjithashtu, në këtë përmbledhje ekzekutive janë përshkruar ndryshimet esenciale infrastrukturore që do të mbështesin zhvillimin e punës kërkimore dhe mësimdhënjes në Fakultetin e Mjekësisë, duke përfshirë këtu edhe mbështetjen e ndërkombëtarizimit të Fakultetit të Mjekësisë. Në këtë aspekt, përveq zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare me Universitetet tjera, këtu gjithashtu përshkruhet një strategji e cila parasheh angazhimin e Diasporës shqiptare dhe alumnit tonë në institucione ndërkombëtare. Ky angazhim do të jetë në baza vizitore dhe rregullta në nivel institucional.

Një ndër strategjitë kyqe që mbështet zhvillimin e Fakultetit të Mjekësisë është edhe pavarësimi funksional. Kjo strategji është prezentuar më poshtë duke përfshirë arsyet se pse ky pavarësim funksional është i nevojshëm në mënyrë që të mbështetet strategjia ambicioze zhvillimore e Fakultetit të Mjekësisë.

Përfundimisht, kjo do të rezultojë në të diplomuar me cilësi më të lartë, sistem më të mirë shëndetësorë në Kosovë si dhe përmirësim të kujdesit dhe sigurisë së pacientit në Kosovë.

Vizioni

Menaxhmenti i ri i Fakultetit të Mjekësisë është duke punuar intensivisht për të përcaktuar prioritet kyqë që do të shtyjnë përpara zhvillimin strategjik të Fakultetit të Mjekësisë gjatë periudhës kohore 2016-2020. Fakulteti i Mjekësisë ka për qëllim arritjen e ekselencës në edukim mjekësorë duke u fokusuar në këto fusha:

- *Cilësia e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes;*
- *Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore;*
- *Infrastruktura e mësimdhënjes dhe punës kërkimore dhe*
- *Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë*

Duke arritur përmirësime sinjifikante të matshme në këto katër fusha prioritare, Fakulteti i Mjekësisë do të riafirmojë pozitën e tanishme të:

- ***Të qenurit ofruesi kryesorë i edukimit shëndetësorë në Kosovë***
 - Shumica e kosovarëve të punësuar në Europën Përendimore dhe SHBA e që punësohen nëpërmjet diplomave universitare të arritura në Kosovë, janë nga Fakulteti i Mjekësisë.
- ***Të qenurit institucioni me performancë më të mirë kërkimore në Kosovë***
 - shumica e publikimeve (të regjistruara në Scopus), nga Universiteti i Prishtinës, vijnë pikërisht nga Fakulteti i Mjekësisë.

Prioritetet e përcaktuara në këtë strategji zhvillimore nuk kanë për qëllim vetëm riafirmimin e pozitës së tanishme të Fakultetit të Mjekësisë në Kosovë. Këto prioritete kanë për qëllim edhe ngritjen e Fakultetit të Mjekësisë në një nivel që do të jetë kompetitiv në krahasim me ofruesit kryesorë të edukimit shëndetësorë në rajon si dhe ofrimin e të diplomuarve të një cilësie të lartë e që do të ju mundëojë atyre që të jenë të gatshëm të bëhen profesionist shëndetësorë të klasit botërorë. Prandaj, Fakulteti i Mjekësisë synon të bëhet:

Ofrues i edukimit shëndetësorë i një cilësie botërore

Fakulteti i Mjekësisë tradicionalisht ka pasur një cilësi të lartë të studentëve të cilët janë pranuar në këtë Fakultet nëpërmjet një procesi mjaft kompetitiv. Kjo ofron një strukturë të dallueshme të studentëve të motivuar dhe talentuar e të

cilët paraqesin një komponent të rëndësishme të vizionit tonë për të arritur ekselencë në edukim shëndetësorë. Përfundimisht, duke përmbushur prioritetet e mësipërme, Fakulteti i Mjekësisë, brenda një periudhe katër vjeçare, synon që të ndërtojë mbi atë që është punuar deri më tash, shfrytëzojë diversitetin kulturor, social dhe religjioz dhe kështu të bëhet një institucion edukativ atraktiv edhe për student ndërkombëtarë nga rajoni dhe bota.

1) Cilësia e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes

Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në Fakultetin e Mjekësisë, si ofrues lider i edukimit mjekësorë në Kosovë, është një komponentë esenciale drejt progresit të përgjithshëm të kujdesit shëndetësorë në Kosovë. Në të njejtën kohë, përmirësimi i këtij aspekti të edukimit, është një top-prioritet i Fakultetit tonë gjatë katër viteve të ardhshme. Fakulteti i Mjekësisë vazhdimisht do të mundohet të përmirësojë përvojën mësimore të studentëve duke u siguruar se ata pajisen me aftësitë e domosdoshme që do tua mundësonte atyre të jenë profesionistë shëndetësorë të klasit botërorë. Në këtë aspekt, strategjia jonë zhvillimore për periudhën 2016-2020 është e fokusuar në optimizimin e shfrytëzimit të teknikave inovative të mësimdhënjes dhe mësimnxënjes (si p.sh. e-learning, mësimi i bazuar në zgjidhje të problemit dhe mësimi i simuluar) si dhe përdorimin e teknologjive që asistojnë në arritjen e ekselencës në cilësinë e mësimit dhe mësimnxënjes. Më tutje, Fakulteti i Mjekësisë gjatë katër viteve të ardhshme do të punojë intensivisht në modernizimin e teknikave të vlerësimit në mënyrë që procesi i vlerësimit të studentëve jetë në linjë me praktikën më të mira moderne dhe duke u siguruar një shkallë të lartë të përpuethshmërisë me praktikën e integritetit akademik. Kjo do të arrihet nëpërmjet trajnimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të stafit akademik.

Fakulteti i Mjekësisë synon të afrojë stafin akademik dhe studentët me praktikën më të mira të Universiteteve moderne duke avancuar mësimin e aftësive klinike dhe fillimin e procesit të përqaftimit të kreativitetit dhe shfrytëzimit të teknologjisë për të facilituar edukimin mjekësorë. Në këtë aspekt, Fakulteti i Mjekësisë tanimë ka inicuar themelimin e **E-lab, Qendrës së Aftësive Klinike**, rolit të **Facilitatorit Klinik** dhe **Qendrës Informative të Barnave**. *Ne i konsiderojmë këto iniciativa si komponente esenciale që do të na mundësojnë të bëjmë hapin e madhë drejt modernizimit dhe internacionalizimit të Fakultetit tonë. Përfundimisht kjo do të rezultojë në të diplomuar më kompetent dhe në një përmirësim aq shumë të nevojshëm të kujdesit shëndetësorë të Kosovës.*

a) E-lab

E-lab do të dizajnohet në mënyrë të që integroj teknologjitë moderne që sunojnë facilitimin e edukimit mjekësorë. Në këtë aspekt, do të përdoren softverë që asistojnë edukimin, e-learning dhe module të edukimit nga distanca.

- ***Përfitimet e pritura:***

- Mundësia për të shfrytëzuar softverë të ndryshëm që do të asistojnë mësimin e studentëve dhe performancën e tyre akademike.
- Mundësia për të matur më mirë aktivitetet mësimore të studentëve
- Shfrytëzimi i softverit kundër plagjiarizmit për të ruajtur integritetin akademik.
- Stimulimi i angazhimit të studentëve dhe ruajtjes së mësimnxënjes
- Mundësia për të ofruar material mësimorë interaktive
- Qasje efektive dhe më e lehtë në databaza të ndryshme
- Mundësia për të integruar më mirë alumni tonë që punojnë në institucione ndërkombëtare
- Facilitimi i trajnimit të vazhdueshëm të stafit tonë akademik në komponente të ndryshme të mësimdhënjes dhe vlerësimit.
- Inicimi i ndërtimit të komponenteve online të lëndëve në programe të ndryshme dhe kështu mbështetja konkrete e facilitimit të bashkëpunimit me staf akademik dhe Universitete ndërkombëtare.

b) Qendra e Aftësisit Klinik

Qendra e Aftësisit Klinik do të jetë një qendër multidisiplinare që do të facilitojë mësimdhënjen dhe mësimnxënjen e aftësive klinike duke simuluar ambiente reale para se studentët të angazhohen në praktikën reale me pacientë. Kjo do të jetë hera e parë që studentët e Fakultetit të Mjekësisë mësojnë në ambient të realitetit të simuluar. Prandaj, Qendra e Aftësisit Klinik do të ofrojë resurse të vlefshme fizike dhe educative që facilitojnë procesin e mësimnxënjes së aftësive klinike.

- ***Përfitimet e pritura:***

- Përmirësim të performancës së studentëve dhe reduktim të ankthit të studentëve para se ata të praktikojnë në pacientë të vërtetë
- Studentët arrijnë një nivel të kënaqshëm të konfidencës dhe profiqencës bazike para punës dhe procedurave me pacientë real.
- Përmirësim i sigurisë së pacientëve dhe mirëqenjes së tyre.
- Mbushja e zbrazëtirës ndërmjet mësimin teorik dhe praktikës klinike

c) Facilitimi klinik

Përmirësimi i eksperiencës klinike të studentëve tonë është një nga themelet e strategjisë tonë zhvillimore. Në këtë aspekt, Fakulteti i Mjekësisë është shumë mirë i pozicionuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Prandaj, ne jemi duke u fokusuar strategjikisht që ta themelojmë rolin e “Facilitatorit Mësimorë Klinik” që do të ri-integrojë përvojën e klinikistëve që punojnë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), në sistemin tonë të edukimit në Fakultetin e Mjekësisë. Roli kyq i Facilitatorëve Mësimorë Klinik do të jetë në asistimin e

studentëve dhe stafit akademik të ri në aktivitetet klinike me qëllim të avancimit të përvojës klinike të studentëve tonë të vitit të fundit (dmth absolventëve). Brenda katër viteve, ne do të punojmë në arritjen e ndërlidhjes 100% të praktikave të simulimit klinik që studentët i bëjnë në Qendrën e Aftësisë Klinik me përvojën reale të studentëve të vitit të fundit, gjithashtu të facilituar nga clinicistët senior të QKUK-së (dmth Facilitatorët Mësimorë Klinik).

- ***Përfitimet e pritura:***
 - Avancimi i eksperiencës klinike të studentëve
 - Shfrytëzimi më i mirë i ekspertizës klinike që është në dispozicion tek ekspertët në QKUK
 - Përmirësimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet Fakultetit të Mjekësisë dhe qendrave të ndryshme në kampusin e QKUK-së
 - Përmirësimi i sigurisë dhe mirëqenjes së pacientëve.

d) Qendra Informative e Barnave

Fakulteti i Mjekësisë rishtazi ka marrë iniciatiën e themelimit të Qendrës Informative të Barnave (QIB), në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, QKUK dhe Agjencinë e Kosovës për Produkte Medicinale. Kjo është e para QIB në Kosovë dhe misioni parësorë i kësaj qendreje është që të sigurohet një përdorim racional i barnave, minimizimi i problemeve nga barnat dhe reduktimi i pranimeve në spital që janë rezultat i përdorimit jo të drejtë të barnave. QIB do të themelohet duke konsideruar rekomandimin zyrtarë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) të vitit 1985 për vendet që themelojnë QIB dhe duke konsideruar edhe kërkesat e Federatës Botërore Farmaceutike për themelimin e QIB. Derisa roli parësorë i QIB do të jetë që clinicistët dhe pacientët e Kosovës të marrin informata të paanueshme mbi barnat, gjithashtu pritet që kjo qendër të ketë efekte positive edhe në përmirësimin e mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në Fakultetin tonë.

- ***Përfitimet e pritura:***
 - Avancimi i aktiviteteve që ndërlidhen me mësimnxënjen dhe mësimdhënjen rreth barnave
 - Shfrytëzimi më i mirë i ekspertizës që për momentin është në dispozicion në Degën e Farmacisë dhe Katedrën e Farmakologjisë
 - Përmirësimi i bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet Fakultetit dhe Klinikave të QKUK
 - Përmirësimi i sigurisë dhe mirëqenjes së pacientëve
 - Mbështetja e clinicistëve të QKUK në lidhje me informim mbi barnat.

Përveq iniciativave të sipërpërmendura që për synim kanë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënjes dhe mësimnxënjes në Fakultetin e Mjekësisë, ne jemi fuqimisht të përkushtuar në sigurimin e mundësive të barabarta gjatë procesit të vlerësimeve, integrimin e kujdesit të orientuar në pacientë në kurikulën tonë, fuqizimin e programeve ekzistuese tona me staf akademik të cilësisë së lartë dhe në shfrytëzimin e alumnit lokal dhe ndërkombëtarë në transferimin e praktikave të mira ndërkombëtare në Fakultetin tonë. Gjatë një periudhe katër vjeçare, këto iniciativa pritet që të zvogëlojnë zbrastirjen ekzistuese ndërmjet industrisë dhe Fakultetit, si ofrues i edukimit, në mënyrë që të përmbushen më mirë nevojat e industrisë dhe që Fakulteti të ofroj të diplomuar që janë më mirë të përgaditur. Në këtë aspekt, planifikojmë që stafi akademik i FM vazhdimisht të trajnohet dhe mbështetet në mënyrë që të realizohet plani strategjik i zhvillimit.

2) Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore

Fakulteti i Mjekësisë për momentin prodhon shumicën e rezultateve të gjithmbarshme kërkimore të Universitetit të Prishtinës. Ne besojmë që FM është në gjendje që të bëjë hapin e radhës që ndërlidhet me kapacitetet kërkimore. Kjo do të arrihet duke u siguruar që brenda një periudhe katër vjeçare, rezultati kërkimorë i Fakultetit të bëhet i krahasueshëm me partnerët rajonal dhe gjithashtu të bëhet ndërkombëtarisht kompetitiv.

Vizioni jonë është që të dyfishohet rezultati kërkimorë FM brenda periudhës katër vjeçare duke u siguruar për një ngritje vjetore të publikimeve për përafërsisht 25%, nga stafi akademik i FM. Në këtë aspekt, zotimet tona të zhvillimit strategjik për katër vitet e ardhshme janë:

- Trajnimi i stafit akademik në lidhje me përgaditjen e grant-aplikacioneve, shkruarjes së projekteve dhe shkruarjes së publikimeve kërkimore
- Trajnimi i stafit akademik në lidhje me praktikën më të mira të integritetit akademik dhe kërkimorë
- Rritja e angazhimit të stafit akademik në lidhje me mundësitë e financimit nga partnerët nga UE dhe SHBA
- Rritja e angazhimit të stafit akademik në mundësitë e kërkimeve klinike që momentalisht ekzistojnë (por që nuk shfrytëzohet sa duhet) përbrenda QKUK
- Përmirësimi i infrastrukturës kërkimore.

Me qëllim të arritjes së një përmirësimi sinjifikant në kapacitetet tona kërkimore, FM planifikon që 50% e stafit tonë akademik jo-profesional (dmth asistentët) të kenë nivelin PhD të edukimit dhe kështu të rritet kapaciteti i kompetencës në raport me zhvillimin, monitorimin dhe asistencën që ata mund të japin në projekte të ndryshme kërkimore në Fakultet. Sa i përket Profesorëve të Fakultetit, vizioni jonë është që 70% e tyre të bëhen aktiv në aspektin kërkimorë deri në vitin 2020. Gjatë kësaj kohe, vizioni është që të arrihet një nivel i cili do të na mundësojë

përcaktimin e Indeksit të Përformacës Kyqe vjetore për punën e **vazhdueshme** kërkimore të Profesorëve tonë.

Me qëllim të rritjes së financimit dhe përmirësimit të kushteve që do të na mundojë avancimin e përformancës kërkimore, menaxhmenti i ri i FM ka planifikuar themelimin e Grupit Punues për Projekte dhe Donacione. Ky grup punues, i cili përbëhet nga stafi akademik i FM, do të mbështetet që gradualisht të forcojë kapacitet e veta dhe kjo do të rezultojë në mbështetje dhe trajnim të stafit tjetër akademik në lidhje me aktivitetet e ndryshme kërkimore dhe të bazuara në projekte.

3) Infrastruktura e mësimit dhe punës kërkimore

Fakulteti i Mjekësisë momentalisht e ka lokacionin në kampusin e QKUK-së. Vizioni jonë është që studentët dhe stafi akademik të kenë bazën e nevojshme infrastrukturore dhe pajisjet që do të mundësojnë atyre të kenë një përvojë të shkëlqyeshme mësimore dhe kërkimore. Ne e pranojmë që kjo është një fushë që kërkon investime sinjifikante në mënyrë që të arrihet një nivel dhe kapacitet i nivelit botërorë.

Menaxhmenti i ri tanimë ka identifikuar një numër aspekteve akute infrastrukturore që kërkojnë përmirësim. Strategjia jonë është që të kërkojmë fonde nga donator të ndryshëm ndërkombëtarë në mënyrë që të përmirësohet infrastruktura mësimore dhe kërkimore e Fakultetit. Gjatë katër viteve të ardhshme, ne planifikojmë që nëpërmjet projekteve të ndryshme dhe donacioneve (të facilituara nga grupi punues i sipërshënuara), kjo do të arrihet. Gjithashtu, strategjia jonë është që për herë të parë, Fakulteti të angazhohet me partner nga industria (ajo farmaceutike dhe mjekësore), me qëllim të marrjes së mbështetjes së nevojshme që do të mundësojë realizimin e përmirësimeve të nevojshme infrastrukturore.

Gjatë katër viteve të ardhshme, vizioni jonë është që:

- Të përfundojmë ndërtesën e re të Dekanatit (momentalisht kjo ndërtesë është në ndërtim e sipër dhe pritet që kjo të përfundojë gjatë vitit 2017)
- Të përfundojmë ndërtesën e Degës së Farmacisë
- Të përfundojmë ndërtesën e për kafshët laboratorike

Projektet e mësipërme infrastrukturore pritet që të përmirësojnë rrënjësisht infrastrukturën mësimore dhe kërkimore në Fakultetin e Mjekësisë. Gjithashtu, FM do të fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës administrative duke optimizuar shfrytëzimin e përdorimit të teknologjisë në aktivitetet ditore administrative, përmirësimin e komunikimit ndërmjet stafit dhe studentëve dhe përditësimin e vazhdueshëm të ëbfaqes së Fakultetit. Kjo pritet të rezultojë në shkallë më të mirë të satisfaksionit të stafit, studentëve dhe palëve të treta.

4) Ndërkombëtarizimi i Fakultetit të Mjekësisë

Një ndër prioritetet tona kyqe është ndërkombëtarizimi i FM. Në këtë aspekt, ne jemi strategjikisht të fokusuar në pëmirësimin dhe zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare më katër palë kyqe:

- Universitetet e klasit botërorë
- Alumnin që punojnë në institucione ndërkombëtare
- Diasporën shqiptare që punon në Universitete ndërkombëtare dhe sektorin shëndetësorë në vende të zhvilluara
- Donatorët ndërkombëtarë të fokusuar në programme të edukimit (p.sh. UE, USAID etj.)

Gjatë katër viteve të ardhshme, ne synojmë ta përmirësojmë rrënjësisht imazhin e Fakultetit të Mjekësisë duke bashkëpunuar ngusht me Universitetet e klasit botërorë. Në këtë aspekt, menaxhmenti i ri tanimë ka vendosur komunikime dhe bashkëpunime me një numër të institucioneve ndërkombëtare duke përfshirë: Geisel School of Medicine (Dartmouth, SHBA), St Vincent University Hospital, University of Derby (Angli), Linkopin University (Suedi), Curtin University (Australi), University of Lyon 1 (Francë). Këto bashkëpunime pritet të rezultojnë në projekte të cilat do të avancojnë mësimdhënjen dhe mësimnxënjen si dhe kapacitetin kërkimorë të FM gjatë katër viteve të ardhshme. Ne synojmë ta zgjerojmë listën e Universiteteve ndërkombëtare me të cilat do të bashkëpunojmë.

Për të arritur ndërkombëtarizimin e FM, menaxhmenti i FM ka planifikuar angazhimin aktiv të alumnit kosovarë që punon në institucione ndërkombëtare dhe diasporën shqiptare që punon në Universitete ndërkombëtare dhe sektorin shëndetësorë. Plani është që të krijohen rolet e Profesorëve Vizitorë dhe Profesorëve të Jashtëm (Adjunct) në FM dhe kjo do të ngrisë angazhimin aktiv të ekspertëve ndërkombëtarë në FM. Në këtë aspekt, Fakulteti planifikon të organizojë vizita mujore, ligjerata dhe ëorkshope nga alumnit ndërkombëtarë dhe ekspertët akademik dhe shëndetësorë të diasporës. Këto vizita pritet që të rrisin në mënyrë sinjifikante aktivitetet mësimore dhe kërkimorë të stafit tonë akademik dhe studentëve në linjë me praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Për të facilituar më tutje procesin e ndërkombëtarizimit, Fakulteti i Mjekësisë ka themeluar rishtazi Bordin Ndërkombëtare të Ekspertëve të Nderit. Ky Bord përbëhet nga Profesorë eminent nga Europa Përendimore, SHBA dhe Australia. Ky Bord do të ofrojë këshilla dhe do të facilitojë ndërkombëtarizimin e FM.

Pavarësia Funktionale

Në mënyrë që të përmbushen prioritetet kyqe të sipërshënuara gjatë shpalimit të vizionit të Fakultetit të Mjekësisë, nevojitet pavarësia funksionale e FM nga Universiteti i Prishtinës. Kjo domosdoshmëri rrjedh nga një numër aktivitete që për momentin FM është e kufizuar t'i performoj si rezultat i centralizimit të kompetencave në nivelin qendrorë të Universitetit. Arsyet kyqe për të cilat nevojitet pavarësia funksionale e FM janë:

- Mundësia për të arritur dhe zbatuar në mënyrë më efikase marrëveshje ndërkombëtare që do të facilitonin ndërkombëtarizimin e FM
- Mundësia për të aplikuar dhe menaxhuar në mënyrë të pavarur dhe më efikase fonde të UE, që do të rezultonte në një stimulim të aplikimeve dhe menaxhim më eficient të projekteve
- Vendosja e rregullave specifike për fushën e Mjekësisë, që momentalisht nuk njihen nga legjislacioni i Universitetit të Prishtinës
- Rritja e pragut të cilësisë dhe kërkesave që ndërlidhen me indeksin e performancës së stafit, duke marrë parasysh se FM ka kapacitete të stafit akademik për të bërë një hap të tillë të rëndësishëm.

Pavarësia funksionale nevojitet për të përmirësuar imazhin ndërkombëtarë të FM, sistemit shëndetësorë të Kosovës dhe për tu bërë kompetitiv në nivelin rajonal dhe ndërkombëtarë në fushën e edukimit mjekësorë si dhe me qëllim të prodhimit të ekspertëve shëndetësorë të nivelit botërorë.

Gjithashtu duhet të theksohet se pavarësia funksionale e Fakultetit të Mjekësisë është rekomanduar nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit gjatë vlerësimit të fundit të programeve të Fakultetit të Mjekësisë.



Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS
Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381-38-512221 URL: <http://www.uni-pr.edu>
Fax: +381-38-512223 Mail: mjekesia@uni-pr.edu

Ref. nr. Prishtinë, ___/___/201__

Rregullorja e Punës së Shefave të Katedrave dhe Shefave të Degëve në Fakultetin e Mjekësisë

Dispozitat e përgjithshme

Rregullore për punën e shefave të katedrave dhe shefave të degëve në Fakultetin e Mjekësisë Dispozitat e përgjithshme Me këtë Rregullore përcaktohen punët dhe detyrat e punës për shefat e degëve dhe shefat e katedrave në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë. Fakulteti i Mjekësisë (në tekstin e mëtejshëm: Fakulteti) është themeluar më 17 qershor 1969 (“Gazeta zyrtare e KSAK” nr. 20/69). Fakulteti ofron arsimim akademik, kërkime shkencore dhe shërbime shëndetësore.

Neni 1

Fakulteti e ka vulën e vet. Fakulteti mban emblemën dhe emrin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” brenda emblemës dhe emrit të vet.

Neni 2

Fakulteti është njësi akademike në kuadër të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Fakulteti ka këto qëllime:

1. Të veprojë si qendër universitare për edukimin e kuadrove shëndetësore, të krijojë kushtet për studime shkencore, të krijojë kuadro universitare dhe të ofrojë shërbime shëndetësore.
2. Të krijojë dhe mbështesë standardet më të larta në fushën e mësimdhënies, mësim nxënies, dhe kërkimeve shkencore; si dhe ta çojë më tej kërkimin e së vërtetës shkencore dhe të mençurisë.
3. Të shfrytëzojë burimet e veta në mënyrë sa më efikase;
4. Të bashkëpunojë dhe të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet arsimore, hulumtuese dhe shëndetësore, në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
5. T’i përvetësojë dhe respektojë standardet evropiane;
6. Të ofrojë edukimin mjekësorë themelorë, specialistik dhe të vazhdueshëm profesional.
7. Të integrohet plotësisht në zonën evropiane të arsimit të lartë dhe në zonën evropiane të kërkimeve shkencore si dhe të ndërmer hapa reformues të nevojshëm për arritjen e këtij objekti.

Neni 3

Fakulteti bën pjesë në zonën integruese evropiane dhe botërore të ofrimit të arsimit të lartë, të hulumtimeve shkencore në fushën e biomjekësisë dhe zotohet të respektojë të gjitha rregullat, standardet dhe përgjegjësitë që dalin nga marrëveshjet dhe të drejtat statutare e ligjore në këtë fushë. Neni 4 Fakulteti obligohet të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë pa asnjë lloj diskriminimi në bazë të gjinisë, moshës, statusit fizik e mendor, racës, gjuhës, religjionit, përkatësisë politike, përkatësisë kombëtare, etnike e sociale.

Neni 4

Të gjithë individët dhe organet e Fakultetit do të sillen në përputhje me standardet më të larta të përkushtimit, integritetit, objektivitetit, përgjegjësisë, sinqeritetit dhe ndershmërisë. I gjithë personeli gjatë gjithë kohës duhet të veprojë vetëm në interes të Fakultetit si tërësi.

Neni 5

Personeli arsimor, shëndetësor dhe studentët e Fakultetit gëzojnë lirinë e bashkimit dhe të shprehjes brenda strukturave të parapara me këtë Rregullore, me Statutin e Universitetit dhe me Ligjin mbi Arsimin e Lartë.

Neni 6

Fakulteti është i organizuar në disiplinat akademike të: 1. Aftësimin profesional 2. Arsimimit akademik; 3. Kërkimit shkencor; 4. Aktiviteteve të tjera të përcaktuara me këtë Rregullore dhe me akte tjera normative në fuqi.

Neni 7

Fakulteti ofron studime të rregullta themelore dhe studime pasdiplomike Universitare. Neni 9 Komisioni i studimeve themelore i Fakultetit të Mjekësisë duke iu referuar punës së shefave të katedrave dhe shefave të degëve mund t'i propozojë Dekanit të formojë nën komisione për: 1. Kontroll, vlerësim dhe cilësi të mësimin; 2. Ankesa dhe parashtresa të studentëve.

Neni 8

Katedrat e Fakultetit të Mjekësisë janë si në vijim:

1. Lëndët para mjekësore (Kimi, Biologji, Biofizikë, Gjuhë Shqipe, Gjuhë Angleze)
2. Anatomia
3. Fiziologji dhe Immunologji
4. Biokimi dhe Biokimi Klinike
5. Farmakologji me Toksikologji dhe Farmakologji Klinike
6. Anatomia Patologjike dhe Histologji me Embriologji
7. Fiziologji Patologjike
8. Mjekësi Interne
9. Mikrobiologji
10. Sëmundjet infektive
11. Neurologji dhe Psikiatri
12. Pediatri dhe Gjenetikë Mjekësore
13. Kirurgji dhe Ndihma e Parë
14. Ortopedi
15. Anesteziologji me Reanimacion dhe Urgjenca Mjekësore

16. Oftalmologji
17. Otorinolaringologji (ORL)
18. Gjinekologji me Obstetrikë
19. Higjienë
20. Epidemiologji
21. Mjekësi Sociale, Mjekësi e Punës dhe Mjekësi Familjare
22. Mjekësi Fizikale me Rehabilitim
23. Sëmundjet e Dhëmbit
24. Protetikë Stomatologjike
25. Ortodonci, Pedodonci,
26. Parodontologji dhe Mjekësi Orale
27. Kirurgji Maksilo Faciale dhe Kirurgji Orale
28. Dermatovenerologji
29. Radiologji
30. Onkologji me radioterapi, Mjekësi nukleare.
31. Mjekësi Ligjore
32. Kimia Farmaceutike
33. Analiza e Kontrollit të Barnave dhe Teknologjia Farmaceutike
34. Praktika e Farmacisë dhe Kujdesi Farmaceutik
35. Kimia Toksikologjike dhe Bromatologjia

Neni 9

1. Themelimi i katedrës është i mundur kur ekzistojnë së paku dy profesor të lëmit përkatës dhe personelit mbështetës nga radha e asistentëve.
2. Katedrën e përbëjnë të gjithë mësimdhënësit dhe asistentët e rregullt.
3. Katedra ka shefin, zëvendësshefin dhe sekretarin.
4. Katedra është njësi organizative themelore e punës mësimore në fakultet. Numri dhe emërtimi i katedrave përcaktohet me këtë rregullore.
5. Katedra e ka për detyrë të zbatojë dhe të harmonizojë mësimin universitar dhe pasuniversitar, të kujdeset për përparimin e të gjitha formave të mësimit, mbi zgjedhjen dhe avansimin e kuadrove të angazhuar në procesin mësimor dhe për të gjitha çështjet tjera që janë të lidhura me efikasitetin e mësimit.

Neni 10

1. Me katedër udhëheq Shefi i katedrës, i cili drejton punën mësimore, shkencore dhe profesionale të katedrës.
2. Shefin e katedrës e propozon katedra dhe e zgjedh Këshilli i Fakultetit.

Neni 11

Mandati i shefit të katedrës zgjatë katër vjet d.m.th. aq sa zgjatë mandati i dekanit dhe prodekanëve siç parashihet në Statutin e UP-së. Shefi i katedrës përgatit, fton dhe udhëheqë mbledhjen e katedrës. Kujdeset për ecurinë dhe cilësinë e veprimtarisë arsimore. Kujdeset për zbatimin e vendimeve të Këshillit të Fakultetit. Shefin e katedrës e ndihmojnë zëvendësi dhe sekretari i katedrës. Zëvendësi dhe sekretari i katedrës zgjidhet me procedurë të njëjtë sikurse shefi i katedrës. Katedra mban mbledhje së paku dy herë në muaj. Pjesëmarrja në mbledhjen e katedrës është e detyrueshme për të gjithë anëtarët e katedrës. Në mbledhjen e katedrës sekretari mban

procesverbalin, një kopje e procesverbalit mbetet në arkiv, ndërsa një kopje tjetër i dorëzohet sekretarit të Fakultetit dhe prodekanit për mësim, pasi të jetë vërtetuar. Vendimet në katedër merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm.

Neni 12

Detyrat e Shefit të Katedrës:

1. Të koordinojë dhe monitorojë punën e stafit akademik brenda katedrës.
2. Të mbajë takime të vazhdueshme me stafin akademik të katedrës.
3. Të përgatis dhe propozojë tek shefi i Degës strategjinë zhvillimore të Katedrës të ndërlidhur me resurset humane, resurset materiale dhe planin e hartimit të teksteve dhe literaturës për studentë.
4. Të monitorojë ambientet mësimore (amfiteatrot, sallat, laboratorët) që janë në përgjegjësi të katedrës.
5. Të informojë Shefin e Degës së paku 1 muaj para fillimit të semestrit, në lidhje me gatishmërinë për të filluar dhe realizuar procesin mësimor për lëndët që mbulojnë nga katedra.
6. Të informojë Shefin e Degës lidhur me realizimin e programit mësimor, problemet me të cilat ballafaqohet dega dhe të jep propozime për zgjedhjen e tyre.
7. Të informojë Shefin e Degës në lidhje me mungesën eventuale të personelit akademik nga procesi mësimor.
8. Të mbikëqyrë rifreskimin dhe zbatimin e syllabuseve të lëndëve përbrenda katedrës.
9. Shefi i katedrës i mbikëqyrë ditarët e lëndëve, protokollet e notave dhe dokumentacionin tjetër që mbahen në katedrën përkatëse.
10. Shefi i Katedrës informon shefin e Degës për çdo afat të provimeve se fletëparaqitjet janë dorëzuar me kohë tek shërbimet administrative përkatëse të Fakultetit.
11. Planifikon dhe dorëzon tek shefi i Degës planin për stafin akademik të nevojshëm për realizimin e procesit mësimorë për lëndët që i mbulon katedra.
12. Shefi i katedrës është përgjegjës për përgatitjen dhe verifikimin e dokumentacionit të lëndëve mësimore për akreditim dhe ri-akreditim të programeve sipas kërkesës së menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë.
13. E parashtron tek Shefi i Degës, planifikimin për personelin akademik dhe joakademik të nevojshëm për punën e katedrës.
14. Në fillim të vitit akademik kërkohet të jetë i përditësuar dokumentacioni i personelit akademik (CV, syllabuset dhe dokumentacionin tjetër).
15. Në marrëveshje me personelin akademik të katedrës përcakton orarin e konsultimeve me student dhe sigurohet që informacioni të jetë i arritshëm për studentët.
16. Është përgjegjës për verifikimin dhe konfirmimin e orëve mujore të realizuara dhe raportuara nga personaliteti akademik i katedrës përkatëse.
17. Shefi i Katedrës obligohet që pas verifikimit dhe nënshkrimit, raportet e realizimit mujor të procesit mësimor t'i dorëzojë tek Shefi i Degës.
18. Në rast të mungesës së Shefit të Katedrës, detyrat dhe obligimet i kalojnë zëvendësit të Shefit të Katedrës.

Neni 13

Detyrat e sekretarit të Katedrës:

1. Të mbajë procesverbalin e mbledhjeve të katedrës dhe arkivimin e tyre.
2. Sipas kërkesës së Shefit të Katedrës asiston në përgatitjen e materialit të Katedrës të nevojshëm për procesin e akreditimit dhe riakreditimit të programeve mësimore.
3. Sipas kërkesës së Shefit të Katedrës përgatit dhe përditëson listën e punimeve shkencore, pjesëmarrjet në konferenca shkencore dhe listën e projekteve shkencore të personelit akademik.
4. Është përgjegjës për mbajtjen e evidencave të vijueshmërisë ditore të cilat ia prezanton shefit të Katedrës për nënshkrim.
5. Sipas kërkesës së Shefit të Katedrës asiston në përgatitjen e materialit të Katedrës të nevojshëm për procesin e akreditimit dhe riakreditimit të programeve mësimore dhe kryen aktivitete tjera sipas kërkesës së Shefit të Katedrës.

Neni 14

1. Katedra harmonizon mësimin e të gjitha bazave mësimore brenda programit dhe planit mësimor të studimeve universitare.
2. Për koordinimin e ecurisë mësimore për lëndët që mësimin e mbajnë dy ose më shumë katedra formohet grupi punues nga përfaqësuesit e atyre katedrave.
3. Katedra në koordinim me Shefin e Degës i propozon Këshillit të Fakultetit nevojën për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e mësimdhënësve dhe asistentëve.
4. Propozon ngritjen profesionale dhe shkencore të kuadrit të katedrës.

Neni 15

Lëndët të cilat nuk përfshihen në kuadër të katedrës mund të formojnë Këshillin e lëndëve. Këshilli i lëndëve është këshill profesional për koordinimin dhe zbatimin e mësimin të atyre lëndëve. Këshilli i lëndëve përbëhet nga mësimdhënësit e atyre lëndëve. Udhëheqësi i këshillit është koordinatori i punëve të cilin e zgjedhë Këshilli i Fakultetit në propozim të mësimdhënësve të lëndëve në mandat katër vjeçar.

Neni 16

Degët Degët kanë programet dhe planet e tyre të mëvetësishme të studimeve themelore dhe pasdiplomike, të cilat veprojnë në kuadër të fakultetit si tërësi organike. Degët e studimeve themelore të Fakultetit të Mjekësisë janë:

1. Mjekësi e Përgjithshme
2. Stomatologji
3. Farmaci
4. Fizioterapi
5. Infermieri
6. Mami

Neni 17

Secila degë e Fakultetit të Mjekësisë duhet ta ketë shefin dhe sekretarin e degës.

Neni 18

1. Degën e udhëheq Shefi i Degës.
2. Shef i Degës mund të zgjidhet mesimdhënësi me thirrje shkencore mesimore i cili shquhet në punën shkencore dhe organizative.
3. Shefin e degës e propozon Dekani, ndërsa e zgjedh Këshilli i Fakultetit.
4. Mandati i shefit zgjat katër vjet, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

Neni 19

Detyrat e Shefit të Degës:

1. Të koordinojë dhe monitorojë punën e katedrave përbrenda degës.
2. Të përgatisë strategjinë zhvillimore të degës dhe ta rifreskojë atë strategji së paku çdo dy vjet
3. Të monitorojë ambientet mesimore (amfiteatrot, sallat, laboratorët).
4. Të informojë Dekanin, përkatësisht prodekanin për çështje akademike lidhur me realizimin e programit mesimorë, problemet me të cilat ballafaqohet dega dhe të jep propozime për zgjidhjen e tyre.
5. Shefi i Degës organizon takime me shefat e katedrave së paku dy herë brenda semestrit, sipas nevojës takimet mund të mbahen edhe më shpesh.
6. Shefi i Degës i mbikëqyrë ditaret e lëndëve që mbahen në degën përkatëse.
7. Është përgjegjës për përgatitjen dhe verifikimin e dokumentacionit për akreditim dhe riakreditim të programeve.
8. Është përgjegjës për konfirmimin e orëve mujore të raportuara nga shefat e katedrave përkatëse.
9. Në koordinim me shefat e katedrave, planifikon dhe prezanton tek Dekani, përkatësisht prodekanin për çështje akademike personelin akademik dhe joakademik të nevojshëm për punën e degës së studimit.

Neni 20

Të mbahet protokoli për vijueshmërinë e studentëve në ligjërata dhe seminare, evidenca për vijueshmërinë në pjesën praktike të mesimit dhe protokoli kryesor i provimit.

Neni 21

Mësimi teorik, seminarët dhe pjesa praktike e mesimit duhet të fillojnë dhe mbarojnë sipas orarit zyrtar të shpallur nga shërbimi përkatës. Katedra obligohet për realizimin e plan-programit, për mirëvajtjen e mesimit dhe të provimeve.

Neni 22

Mësimdhënësit i përgjigjen shefit të katedrës për realizimin e plan-programit dhe për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e mesimit dhe mbajtjen e provimit. Shefi i Katedrës i përgjigjet shefit të Degës dhe Prodekanit për mesim, Dekanit si dhe Këshillit të Fakultetit.

Neni 23

Shefi i Katedrës duhet ta informojë me shkrim shefin e Degës lidhur me përfundimin e mësimit nga lëndët mësimore përkatëse, me analizë të vijueshmërisë dhe shkallës së kalueshmërisë së studentëve si dhe të angazhimit të kuadrit mësimor në realizimin e plan-programit.

Neni 24

Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar dhe paraparë me këtë rregullore merret për bazë rregullorja e studimeve themelore, Statuti i UP-së dhe aktet normative në fuqi. Plotësimi dhe ndryshimet e kësaj rregulloreje bëhen sipas mënyrës së miratimit. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë dhe Senati i UP-së. Me rastin e miratimit të kësaj rregulloreje obligohen shefat e degëve dhe të katedrave zbatimin e saj.

D E K A N E

Prof. dr. Suzana Manxhuka – Kërliu



Universiteti i Prishtinës
“Hasan Prishtina”

UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Fakulteti i Mjekësisë

Bulevardi i Dëshmorëve p.n, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381-38-512221 URL: <http://www.uni-pr.edu>

Fax: +381-38-512223 Mail: mjekesia@uni-pr.edu

Ref. nr.

Prishtinë, ___/___/2016

Në mbështetje të nenit 87, 88, 89, 90, 92, 96, 97 dhe 117, 118 të Statutit të Universitetit të Prishtinës – përkitazi me organizimin e studimeve master, Komisioni i propozon Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë aprovimin e kësaj Rregullore.

Këshilli i Fakultetit të Mjekësisë në mbledhjen e mbajtur më _____, aprovoi këtë:

Rregullore për studimet master në Fakultetin e Mjekësisë

Dispozitat e përgjithshme

Fakulteti i Mjekësisë (në tekstin e mëtejshëm: Fakulteti) është themeluar më 17 qershor 1969 (“Gazeta zyrtare e KSAK” nr. 20/69), dhe ka nisur funksionimin më 04 dhjetor 1969. Fakulteti ofron arsimim akademik, kërkime shkencore dhe shërbime shëndetësore.

Fakulteti e ka vulën e vet. Fakulteti mban emblemën dhe emrin e Universitetit brenda emblemës dhe emrit të vet.

Neni 1

Më këtë Rregullore përcaktohen kriteret e posaçme të organizimit të studimeve të nivelit master në Fakultetin e Mjekësisë.

Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet postdiplomike master kanë të diplomuarit nga degët Fizioterapi, Infermieri dhe Mami, të cilët sipas deklaratës së Bolonjës kanë grumbulluar jo më pak se 180 ECTS kredi.

Studimet postdiplomike master janë vazhdimësi e studimeve themelor (bachelor), dhe organizohen me qëllim të:

- thellimit të njohurive dhe diturive të reja relevante nga fushat përkatëse studimore dhe zbatimit të tyre në praktikë;
- Aftësimin bazik të kandidatëve për punë të pavarur kërkimore-hulumtuese;

Neni 2

1. Duke marrë parasysh kapacitetet mësimore, mentoriale dhe hulumtuese, Fakulteti propozon numrin e studentëve për regjistrim, ndërsa vendimin

përfundimtar për numrin e studentëve e merr Senati i Universitetit të Prishtinës.

2. Kandidatët e pranuar, me të gjitha të dhënat dhe kriteret e përzgjedhjes shpallen publikisht në uebfaqen e Fakultetit dhe të Universitetit të Prishtinës.

3. Regjistrimi bëhet në fillim të viti akademik, sipas kushteve të parapara në konkurs dhe studenti i cili regjistrohet në këto studime ka statusin e studentit të rregullt.

Organizimi dhe llojet e studimeve.

Neni 3.

1. Fakulteti i Mjekësisë organizon studime të rregullta master për fitimin e gradës akademike në lëmenjtë e përcaktuar me plan-programin mësimor të studimeve master, të aprovuar paraprakisht nga Senati i Universiteti të Prishtinës.

2. Fakulteti i Mjekësisë mund të organizojë studimet master edhe në bashkëpunim me Fakultetet e tjera të Universitetit të Prishtinës. Për këtë qëllim mund të ofrojë programe dylëndore dhe programe ndërdisiplinore të studimeve.

3. Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës mund të organizojë studimet master edhe në bashkëpunim me Fakultetet e tjera të Universiteteve jashtë vendit, mbi bazën e programeve të përbashkëta të studimeve dhe memorandumeve për partneritet.

Neni 4.

1. Për regjistrim në studimet master kanë të drejtë të konkurrojnë të gjithë studentët të cilët i kanë kryer studimet themelore (bachelor) në njërën nga degët: Fizioterapi, Infermieri dhe Mami dhe kanë fituar së paku 180 kredi (ECTS).

2. Të drejtë konkurrimi kanë edhe kandidatët të cilët studimet themelore i kanë kryer jashtë vendit e të cilat njihen nga EUA (Shoqata e Universiteteve Evropiane) ose institucioni i cili është pranuar nga një agjenci ndërkombëtare e akreditimit, pasi kanë përfunduar nostrifikimin e diplomave nga institucionet përkatëse shtetërore.

3. Ekuivalentimin dhe nostrifikimin e certifikatave – diplomave të fituara jashtë vendit e bënë Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në bazë të ligjit dhe rregulloreve përkatëse

4. Studentët të cilët në studimet themelore kanë arritur notën mesatare 8.00 e më tepër, mund të regjistrohen në studimet master pa provim pranues. Përzgjedhja e kandidatëve deri te numri i paraparë me konkurs bëhet sipas rangimit të atyre që kanë konkurruar në bazë të notës mesatare të arritur gjatë studimeve themelore.

5. Në rastet kur numri i kandidatëve të paraqitur është më i vogël se numri i shpallur me konkurs, atëherë për vendet e mbetura të lira mund të pranohen edhe

studentë me notë mesatare nën 8.00 në studimet themelore. Në këtë rast, ata i nënshtrohen provimit kualifikues të përcaktuar nga ana e Fakultetit.

Neni 5.

1. Të drejtën e dhënies së mësimi në studimet master e ka personeli mësimor në thirrje të Profesorit i cili i plotëson kushtet e parapara me statutin e Universitetit të Prishtinës, (Profesor i Rregullt, Profesor i Asocuar dhe Profesor Asistent). Të drejtën e mbajtjes së ushtrimeve dhe seminareve në studimet master e kanë edhe Asistentët, të cilët i kanë të regjistruara ose të kryer studimet e doktoratës. Me marrëveshje të veçantë, në ushtrimet praktike, mund të ndihmojnë dhe asistojnë edhe punëtorët shëndetësor në njësitë përkatëse të cilët kanë përvojë të gjatë të punës.

2. Në raste të caktuara, një lëndë mësimore mund ta mbajnë dy ose më shumë mësimdhënës.

3. Në rastin kur mësimin e mbajnë më shumë se një mësimdhënës, në indeks apo programin gjegjësisht shënohet emri i bartësit të lëndës. Njëkohësisht, bartësi i lëndës pas grumbullimit të rezultateve, është përgjegjës për vendosjen e notës së provimit.

4. Listën e mësimdhënësve dhe Asistentëve të propozuar nga Departamentet për realizimin e programit në studime master e aprovon Këshilli i Fakultetit.

Neni 6.

1. Studimet master në Fakultetin e Mjekësisë organizohen në programet e akredituar për studimi master si p.sh.:

1. Fizioterapi,
2. Infermieri
3. Mami

Neni 7.

1. Studimet master i udhëheq komisioni studimeve master. Komisionin e përbëjnë 3 anëtar të degëve përkatëse dhe 2 anëtar tjerë të përcaktuar nga Dekanati, përfshirë këtu Prodekanin për mësim.

2. Komisionin e studimeve master e kryeson Prodekani për Mësim.

3. Me propozim të Komisionin të studimeve master, Këshilli i Fakultetit cakton nga një udhëheqës për secilin program të studimeve master. Udhëheqësit e programeve të studimeve master, në koordinim me Prodekanin për Mësim, koordinojnë dhe mbikëqyrin mësimdhënien dhe progresin e studentëve në studimet master.

4. Udhëheqësit e studimeve master paraqesin raport vjetor për progresin në studimet master në programet përkatëse.

Neni 8.

1. Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, seminareve, ushtrimeve teorike, punës praktike dhe punës në terren, punës profesionale dhe shkencore – mësimore, diskutimeve, konsultimeve profesionale dhe nëpërmes punimeve të pavarura të studenteve, si dhe punimit përfundimtar (diplomës) për arritjen e titullit master.

Kushtet e regjistrimit në studime

Neni 9.

1. Numri i studentëve që regjistrohen në studimet master në Fakultetin e Mjekësisë, ashtu siq është specifikuar në Nenin 2, pikën1, në përputhje me kapacitetet mësimore, mentoriale dhe hulumtuese si dhe nga analiza e nevojave të shoqërisë dhe tregut të punës.

2. Propozimin për regjistrimin e studentëve të rinj e jep departamenti përkatës dhe e miraton Këshilli i Fakultetit.

3. Vendimin përfundimtar për shpalljen e konkursit publik e bën Senati i Universitetit të Prishtinës.

Neni 10.

1. Përzgjedhja e kandidatëve sipas nenit 3 (tre) të kësaj Rregullore e bën Komisioni përkatës me së paku 3 anëtarë, të cilët propozohen nga Dekani dhe zgjedhen nga Këshilli i Fakultetit.

2. Komisioni duhet të jetë kompetent dhe profesional sipas lemisë së studimeve.

3. Komisioni në bashkëpunim me Dekanatin e Fakultetit e shpall ranglistën e kandidatëve që kanë aplikuar. Shpallja e ranglistës së pranimit të kandidatëve bëhet në ueb faqen e Fakultetit, në kohën e paralajmëruar nga Dekanati i Fakultetit. Ranglista mund të shpallet edhe si kopje fizike në letër në tabelën e shpalljeve të Fakultetit, por jo më pak se 24 orë nga shpallja në ueb faqen e Fakultetit.

5. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në studimet master mund të ushtrojnë ankesë me shkrim në Dekanat brenda dy ditëve të punës pas publikimit të rezultateve.

6. Vendimi për ankesat e ushtruara merren në afatin prej dy ditë pune pas ushtrimit të ankesës.

Neni 11.

1. Regjistrimi i studentëve në semestrin e parë në studimet master bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit të Prishtinës. Çdo student pajiset me ID kartel nga zyrtaret e IT-së .

Neni 12.

1. Me rastin e konkurrimit kandidatët duhet të sjellin këto dokumente:

- certifikatën e lindjes (origjinal ose të noterizuar),
 - diplomën (certifikatën) e kryerjes së fakultetit (origjinal ose të noterizuar),
 - vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit (origjinal ose të noterizuar),
2. Kandidatet e pranuar, për regjistrim paraqesin:
- fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
 - tri fotografi (formati 4,5 x 6 cm),
 - pagesën në lartësi të përcaktuar nga Universiteti i Prishtinës sipas akteve normative në fuqi.
3. Dokumentet e dorëzuara nga studenti me rastin e regjistrimit mbeten në shërbimin e studenteve. Shërbimi i studentëve bën regjistrimin e studentëve të rinj në librin amzë, në programin e veçantë softuerik dhe formon dosjen e studentit.

Neni 13.

1. Studimet master zgjasin 2 vjet apo katër semestra. Në çdo semestër me dhënien e provimeve studenti fiton 30 ECTS duke arritur gjithsej 120 kredi ECTS me mbarimin e studimeve.
2. Studenti me kushte të përcaktuara me Statutin e UP-së, e ruan statusin e studentit të rregullt edhe për dy vite të tjera pas afatit dy vjeçar sa zgjasin studimet master.
3. Fillimi dhe mbarimi i semestrave mësimor bëhet sipas dispozitave të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit.

Neni 14.

1. Personi i regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë e ka statusin e studentit të rregullt. Statusi i studentit dëshmohet me indeks ose me ndonjë dokument ekuivalent. Në rast të humbjes së indeksit, me lejen e Dekanit të Fakultetit studentit i jepet “indeksi duplikat”
2. Kërkesës për indeks duplikat duhet t’i bashkëngjitet dëshmia se indeksi është shpallur i pavlefshëm dhe se është bërë pagesa sipas rregullores.
3. Kushtet për fitimin dhe humbjen e statusit të studentit janë të rregulluara me Statutin e Universitetit të Prishtinës.
4. Këshilli i Fakultetit i përjashton nga Fakulteti përkohësisht ose përgjithmonë studentët të cilët i shkelin rregullat e përcaktuara me Rregulloren për procedurën disiplinore të Universitetit të Prishtinës.
5. Humbja e statusit të studentit rregullohet me dispozita të Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Të drejtat dhe obligimet e studenteve

Neni 15.

1. Të drejtat dhe obligimet e studentëve janë të përcaktuara me Statut të Universitetit të Prishtinës dhe të njëjtat vlejnë edhe për studentët e studimeve master në Fakultetin e Mjekësisë.

Neni 16.

1. Përcaktimi i përgjegjësisë disiplinore të studentëve më për së afërmi rregullohet me Rregulloren për Procedurën Disiplinore të Universitetit të Prishtinës.

Neni 17.

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të shqiptuar nga organet e Fakultetit për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

2. Ankesat e tilla i dorëzohen Komisionit të studimeve Master të Fakultetit brenda 8 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.

3. Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e shqiptuar Këshillit të Fakultetit brenda 30 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.

4. Ankesa rreth vendimit të shkallës së parë vendoset nga Senati i Universitetit.

Kushtet e regjistrimit të vitit Provimet dhe sukcesi në provime

Neni 18.

1. Studentët janë të obliguar dhe kanë të drejtë të paraqesin dhe të japin provime. Provimet jepen nga të gjitha lëndët e parapara me planin e studimeve, pas përfundimit të mësimit të lëndës përkatëse.

2. Studenti fiton të drejtën t'i nënshtrohet provimit nga një lëndë pasi t'i kryej obligimet që parashihen me programin mësimor dhe me syllabusin e lëndës përkatëse.

3. Të gjitha syllabuset e lëndëve janë publike dhe u jepen studentëve në fillim të semestrit. Syllabuset për të gjitha lëndët aprovohen nga Këshilli i Studimeve Master.

4. Provimet mbahet: (i) me shkrim, (ii) me gojë ose (iii) me shkrim dhe me gojë. Forma e provimit përcaktohet në mënyrë specifike për secilën lëndë në syllabuset përkatëse.

5. Për vlerësimin e suksesit akademik të studentit, mund të aplikohen edhe këto forma pune: Kolokviumi, punimi seminarik, testi dhe ushtrimet praktike. Në rast se këto aplikohen, atëherë duhet të jenë të parapara në syllabuset e lëndës përkatëse.

Neni 19.

1. Senati i Universitetit të Prishtinës me vendim të veçantë përcakton kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studentëve.

Neni 20.

1. Provimet në studimet master mbahen gjatë vitit akademik sipas afateve të lejuara me Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe me udhëzime të Senatit të Universitetit të Prishtinës.

Neni 21.

1. Suksesi i studentit në provim shprehet me nota 5 (pesë) deri në 10 (dhjetë) në përputhje me Statutin e Universitetit të Prishtinës. Nota shënohet me numër dhe me tekst në fletëparaqitje dhe në indeks.

2. Kandidati kalon provimin me sukses nëse merr notën 6 – 10

3. Suksesi në provime vlerësohet me këto nota:

- a) 10 dhe 9 (shkëlqyeshëm)
- b) 8 (shumë mirë)
- c) 7 (mirë)
- d) 6 (mjaftueshëm) dhe
- e) 5 (pamjaftueshëm)

4. Fletëparaqitjet dhe procesverbali i provimit i dërgohen referentit i cili më së voni 2 ditë pas kryerjes së provimit e regjistron në kompjuter, në librin amzë dhe në dosjen e studentit. Provimet janë publike dhe shpallen në tabelën e shpalljeve në departamentet përkatëse.

Neni 22.

3. Nota ekuivalentet për të përshkruar nivelin e suksesit në provime për studentët të cilët janë transferuar nga ndonjë universitet jashtë atij të Prishtinës janë si më poshtë:

- i. **10 (A) SHKËLQYESHËM** – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore
- ii. **9 (B) SHUMË MIRË** – mbi mesatare standarde, por me disa gabime
- iii. **8 (C) MIRË** – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen
- iv. **7 (D) KËNAQSHËM**- mirë, por me mjaftë gabime
- v. **6 (E) MJAFTON** – rezultatet plotësojnë kriteret minimale

- vi. **5* (FX)DOBËT**- kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kreditë
- vii. **5 (F)DOBËT** – kërkohet shumë punë për të fituar kreditë

Neni 23.

1. Për studentët të cilët nuk janë të kënaqur me vlerësimin dhe notën e marrë në provim, vlejnjë dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Punimi i diplomës – teza për master

Neni 24.

1. Studenti që i ka kryer obligimet e parapara me planin dhe programin mësimor të studimeve përkatëse, e fiton të drejtën të marrë temë e diplomës për master.
2. Studimet master në Fakultetin e Mjekësisë për degët përkatëse përfundojnë me përgaditjet e punimit dhe mbrojtjen publike të temës së diplomës në pajtim me programin e studimeve.

Neni 25.

1. Mësimdhënësit që marrin pjesë në mbajtjen e mësimin në studimet master, gjatë vitit akademik i propozojnë Komisionit të studimeve master, së paku tetë tituj të temave për punimin e tezës për master me arsyetim përkatës. Mësimdhënësi që e ka propozuar temat përkatëse, gëzojnë të drejtën e mentorve potencial i atyre temave.

2. Mentori nuk mund të ketë me shumë se tetë tema. Këshilli i Fakultetit me vendim të veçantë do të vendos për numrin e temave të diplomës – tezës master për të cilat një mësimdhënësi mund të jetë mentor gjatë një viti akademik. Studentët, në marrëveshje me mësimdhënësit e lëndës, mund të propozojnë tituj tjerë të temave të diplomës – tezës për master.

Neni 26.

1. Punimi për master elaborohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushën shkencore për të cilën është përcaktuar studenti.

Neni 27.

1. Punimi i diplomës për master mund të elaborohet bashkë me nga dy ose tre studentë (grup kërkimor) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.

Neni 28.

1. Studenti duhet të përgatisë një propozim me shkrim për lejimin e temës së diplomës. Propozimi mund të përgatitet edhe në bashkëpunim me një mësues të studimeve master.

2. Propozimi për lejimin e temës master aprovet nga Komisioni i Studimeve Master.

3. Ky propozim mund të përgatitet dhe të dorëzohet për aprovim në Këshillin e Studimeve master gjatë vijimit të semestrit të tretë të studimeve master.

4. Propozimi me shkrim për lejimin e temës së diplomës – tezës master, do të bëhet në formularët e veçantë të përgaditur nga Fakulteti ose Universiteti, të cilët në mes tjerash, më s'paku duhet të përmbajnë: titullin e temës, arsyetimin e temës së propozuar, qëllimin shkencor të punimit, hipotezat apo pyetjet hulumtuese si dhe metodologjinë që do të zbatohen realizimin e hulumtimit.

5. Forma dhe përmbajtja specifike e propozimit miratohet nga Komisioni i Studimeve Master.

Neni 29.

Komisioni i studimeve master e shqyrton dhe e miraton propozimin për lejimin e temës së diplomës të studimeve master dhe e lejon punimin e diplomës për master më së largu 30 ditë nga data e dorëzimit të propozimit nga ana e studentit. Me këtë rast Këshilli emëron mentorin i cili e udhëheq studentin gjatë punës në temën e punimit të diplomës për master.

Neni 30.

Punimi i diplomës për master paraqet punim të pavarur profesional të kandidatit të cilin ai tregon që ka përvetësuar njohuritë teorike dhe praktike dhe se mundet të parashtrijë dhe të zgjidh probleme komplekse shëndetësore dhe socioekonomike që kërkojnë aplikim të një qasje dhe metodologjie shkencore dhe profesionale të nivelit të studimeve master.

Neni 31.

Kandidati në afat prej më së shumti një viti pas vërtetimit të semestrit të katër të studimeve master duhet të dorëzojë punimin e përfunduar me shkrim të diplomës për vlerësim.

Me kërkesë të kandidatit, Komisioni i studimeve master mund të caktoj një afat të ri më së shumti deri në gjashtë muaj për të dorëzuar punimin e diplomës. Arsyet për shtyrjen e afatit i vlerëson Komisioni i Studimeve Master.

Në qoftë se kandidati nuk e dorëzon punimin e përfunduar të diplomës për vlerësim në afatin e caktuar me këtë nen, kandidati duhet ta rifillojë procedurën për lejimin e punimit të diplomës, përkatësisht ta rikthej statusin e studentit të rregullt në pajtim me dispozita të Statutit të UP-së.

Mentori duhet të aprovojë punimin e diplomës së studentit para se studentit të dorëzojë atë për vlerësim. Në raste të veçanta, kur nuk arrihet pajtueshmëri në mes të mentorit dhe kandidatit, atëherë studentit ka të drejtë të dorëzojë punimin e diplomës për vlerësim edhe pa miratimin e mentorit.

Neni 32.

Pas dorëzimit të punimit të përfunduar të diplomës për vlerësim nga ana e studentit, Këshilli i Fakultetit me propozim të Prodekanit për Mësim si kryesues i Komisionit të studimeve master dhe të udhëheqësit të studimeve master të departamentit përkatës, cakton 'Komisionin për vlerësimin e punimit të diplomës për master'. Ky komision caktohet në mbledhjen e parë të radhës të Këshillit të Fakultetit ose më së largu 30 ditë prej ditës të paraqitjes të kërkesës të studentit.

Brenda 30 ditëve nga dita e caktimit të Komisionit për vlerësim të diplomës për master nga ana e Këshillit të Fakultetit, ky komision përgatit raport me shkrim dhe ja paraqet atë Këshillit të Fakultetit. Komisioni për vlerësim të punimit të diplomës për master, me shumicë të anëtarëve, i propozon Këshillit të Fakultetit që:

- (i) punimi të miratohet dhe kandidatit t'i lejohet mbrojtja,
- (ii) punimi të plotësohet dhe pastaj t'i lejohet mbrojtja ose
- (iii) të refuzohet.

Anëtari i komisionit i cili nuk pajtohet me propozimin nga alinea paraprake e këtij neni është i detyruar që mendimin ta ndaj dhe ta paraqet në formë të shkruar.

Neni 33.

Komisioni për vlerësimin e punimit të diplomës për master përbëhet prej tre anëtarëve. Sipas nevojës, Këshilli i Fakultetit mund të formojë komisionin prej pesë anëtarësh.

Anëtarë të komisionit mund të jenë të gjithë mësuesit e Fakultetit në thirrje të profesorit (profesor i rregullt, profesor i asocuar, profesor asistent), pavarësisht a janë të angazhuar në mësime në studimet master. Sipas nevojës, Këshilli i Fakultetit mund të caktojë anëtarë të komisionit për vlerësimin e punimit të diplomës për master edhe mësuesit nga njësiti e tjera akademike të Universitetit të Prishtinës.

Mentori që ka mbikëqyrë studentin gjatë punimit të temës së diplomës për master nuk mund të jetë anëtarë i komisionit.

Neni 34.

Në bazë të propozimit të Komisionit për vlerësimin e punimit të diplomës për master, Këshilli i Fakultetit merr vendim përfundimtar për raportin e komisionit, vlefshmërinë e punimit të diplomës për master dhe lejimin e mbrojtjes publike. Komisioni për mbrojtje formohet në përbërje të përcaktuar me nenin 32 të kësaj Rregulloreje.

Neni 35.

Në rast se Komisioni për vlerësim të punimit të diplomës për master propozon që punimi të plotësohet (dhe ky propozim aprovohet nga Këshilli i Fakultetit), atëherë studenti obligohet që në një afat prej 30 ditësh të bëjë plotësimet e kërkuara. Pas kësaj, procedura e aprovimit të raportit të Komisionit për vlerësim të punimit të diplomës për master në Këshillin e Fakultetit përsëritet prapë. Këtë mundësi kandidati mund ta shfrytëzojë vetëm një herë, pas secilës herë kandidati duhet të përgatisë propozimin e ri për paraqitje të temës së diplomës siç parashihet në nenin 27 të kësaj rregullore.

Neni 36.

Në rast se Komisioni për vlerësim të punimit të diplomës për master propozon që punimi të refuzohet (dhe ky propozim aprovohet nga Këshilli i Fakultetit), atëherë studenti obligohet që të përgatisë një propozim të ri me shkrim për lejimin e temës së diplomës, siç parashihet në nenin 27 të kësaj rregullore.

Neni 37.

Në rast se Komisioni për vlerësim të punimit të diplomës për master propozon që punimi të miratohet dhe kandidati t'i lejohet mbrojtja (dhe ky propozim aprovohet nga Këshilli i Fakultetit), atëherë në afatin prej 15 ditësh ky komision në bashkëpunim me kandidatin cakton datën e mbrojtjes së temës. Mbrojtja e temës duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e aprovimit të raportit të Komisionit për vlerësim të punimit të diplomës për master nga Këshilli i Fakultetit.

Neni 38.

Shërbimi administrativ i Fakultetit jep lajmërimin për mbrojtjen e punimit të masterit 5 ditë pune para ditës së mbrojtjes. Lajmërimi jepet në tabelën e shpalljeve të Fakultetit, dhe në faqen e internetit të Fakultetit. Në lajmërim jepen të dhënat për kandidatin, tema e punimit dhe njoftimi se mbrojtja do të jetë publike.

Procedurat e mbrojtjes

Neni 39.

Kryetari i komisionit e hap seancën për mbrojtjen publike të punimit të masterit, paraqet të dhënat lidhur me procedurën e zhvilluar deri në nxjerrjen e vendimit mbi lejimin e mbrojtjes të punimit si dhe paraqet raportin e Komisionit për vlerësimin e punimit të masterit.

Kandidati bënë një prezantim – paraqitje të përmbledhur të punimit jo më gjatë se 30 minuta.

Anëtarët e komisionit përmes pyetjeve që ia shtrojnë kandidatit dhe përgjigjeve të tij, e bëjnë verifikimin e autorësisë të punimit dhe vlerësojnë nivelin e njohjes së problematikës që trajtohet në punim.

Publiku nuk ka të drejtë t'i shtrojë pyetje kandidatit.

Neni 40.

Në mbrojtjen e temës të masterit mund të jetë prezent edhe mentori. Për prezencën ose mos prezencën e tij në mbrojtje vendos kandidati.

Mentori nuk ka të drejtë fjale gjatë gjithë mbrojtjes së temës. Ai mund të flasë vetëm në rast se kryetari i komisionit i kërkon atij/asaj në mënyrë specifike që të përgjigjet në ndonjë pyetje apo sqarim të anëtarëve të komisionit në rastin kur studenti nuk është në gjendje të japë shpjegim adekuat sipas vlerësimit të komisionit.

Neni 41.

Kryetari i komisionit e bënë përfundimin e mbrojtjes dhe e fton komisionin që të mblidhet për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendimin përfundimtar për mbrojtje publike. Vendimi i komisionit shpallet publikisht para auditorit.

Neni 42.

Kandidati konsiderohet se ka mbrojtur me sukses punimin e masterit nëse shumica e anëtarëve të komisionit japin vlerësimin pozitiv për mbrojtjen e punimit.

Nëse kandidati nuk e ka mbrojtur me sukses punimin e masterit, ai mund të paraqet propozim të ri të punimit të masterit brenda 30 ditëve prej ditës së njoftimit se nuk e ka mbrojtur publikisht punimin e masterit.

Neni 43.

Pas përfundimit të studimeve dhe mbrojtjes me sukses të tezës së masterit, kandidati fiton thirrjen akademike master i fushës përkatëse.

Pas fitimit të thirrjes akademike master, kandidati nga shërbimet përkatëse të Fakultetit të Mjekësisë dhe Universitetit të Prishtinës merr certifikatën e nënshkruar nga dekani dhe diplomën e nënshkruar nga dekani dhe rektori.

Fakulteti dhe Universiteti mbajnë evidencën e studentëve të diplomuar në studimet master.

Neni 44.

Thirrja e masterit, kandidatit mund t'i kontestohet ose edhe t'i merret nëse konstatohet se punimi i masterit është plagjiat ose është ndonjë falsifikim.

Në rast të dyshimit të bazuar, Këshilli i Fakultetit e formon komisionin prej tre anëtarëve që të shqyrtoj dyshimet e paraqitura lidhur me punimin e masterit.

Këshilli i Fakultetit e shqyrton raportin e komisionit dhe nëse konstaton dyshimet nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, i propozon Senatit të UP-së marrjen e thirrjes së masterit.

Senati i Universitetit të Prishtinës e merr vendimin përfundimtar për marrjen e thirrjes së masterit.

Dispozitat kalimtare

Neni 45.

Kjo rregullore hynë në fuqi me miratim nga Senati i UP-së.

Me miratimin e kësaj rregullorjeje, shfuqizohet Rregullorja paraprake e studimeve master të Fakultetit të Mjekësisë .

Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Ligjit për Arsimin e Lartë të Kosovës.

Në rast të ndonjë konflikti/kundërshtimi në mes të neneve/dispozitave të kësaj rregullore dhe Statutit të Universitetit të Prishtinës, vlen Statuti i Universitetit të Prishtinës.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje mund të bëhen sipas procedurës me të cilën është miratuar.

Prishtinë dt. 31 .03.2016

DEKANE

Prof. Dr. Suzana Manxhuka – Kërliu



Confidentiality Statement

Deklaratë e Konfidencialitetit

I _____, hereby morally and legally declare that will NOT disclose nor discuss any information to any parties regarding the interview including questions during the Dartmouth Exchange Program interview until the end of interviews today at 2PM.

Unë _____, moralisht dhe ligjërisht deklaroj që NUK do të zbuloj ose diskutoj asnjë informacion tek asnjë palë në lidhje me intervistën ose pyetjet gjatë intervistimit për Programin Dartmouth të Këmbimit deri në përfundimin e procesit të intervistimit në ora 14:00.

Name/Emri: _____

Signature/Nënshkrimi: _____

Prishtinë, 24.03.2016



Deklaratë e Konfidencialitetit

Unë moralisht dhe ligjërisht deklaroj që do të respektoj parimet etike të parapara me Kodin Etik dhe rregulloret në fuqi të Universitetit të Prishtinës dhe Fakultetit të Mjekësisë si dhe NUK do të zbuloj ose diskutoj asnjë informacion konfidencial tek asnjë palë e tretë në lidhje me punën në:

Gjithashtu, moralisht dhe ligjërisht deklaroj që e kuptoj që çdo shkelje e konfidencialitetit dhe e parimeve të mësipërme etike mund të rezultojë në masa përkatëse disiplinore.

Emri: _____

Nënshkrimi: _____

Prishtinë, ___/___/_____



Confidential Document

Interview Guide for students applying for the **Dartmouth Exchange Program**

Faculty of Medicine
University of Prishtina
March 2016

Interview instructions:

- The duration of the student interview should be no longer than **10** minutes. It is important that the same amount of time is available for each student.
- Prior to the interview, the students should be briefed about the interview process.
- The interview is conducted in ENGLISH language.
- Each student is to be marked based on documentation submitted, which includes their CV, fulfilment of key criteria determined by the Panel and recommended by Dartmouth, as well as questions used during the interview.
- Panel members will mark the student in two sections, section A (which includes documentation submitted by candidates) and section B (which includes specific mainly behavioural questions for the candidate)
- Each panel member must mark the student independently.
- At the end of each interview, marks are compared with other panel members and a final score is calculated.
- Please ensure NO copies of the interview are handed to students or left unaccounted for.
- Thank you very much for your help.

Student:

Section A	
Candidates' key characteristics*	Marks
Students' CV (active conference participation-local oral =3) vs poster =1), active conference participation-international (oral =5 vs poster =3), student activities =2, project experience = 2, voluntary experience= 2, exchange programs=5)	_____/20
Comment:	
Students' academic performance (>8 grade average) 0.1 for each grade point	_____/20
Comment:	
Completion of relevant units Gynaecology, Paediatrics 6=2; 7=4; 8=6; 9=8; 10=10	_____/20 (10+10)
Comment:	
Total Marks in Section A	

*Please note the student must be in years five or six of academic study program at the Faculty of Medicine, General Medicine

Section B	
Please rate the student based on below scoring system: Poor = 1; Fair =2; Good = 3; Very good = 4; Excellent = 5	
Teamwork	
During your tutorial and practice work with other students, tell us specifically what have you done to show that you are a good team player	
Poor = 2 <input type="checkbox"/> ; Fair =4 <input type="checkbox"/> ; Good = 6 <input type="checkbox"/> ; Very good = 8 <input type="checkbox"/> ; Excellent = 10 <input type="checkbox"/>	
Comment:	
Adaptability	
Tell us why do you think you are the best candidate for Dartmouth exchange program and do you think you could adapt well in the US	
Poor = 2 <input type="checkbox"/> ; Fair =4 <input type="checkbox"/> ; Good = 6 <input type="checkbox"/> ; Very good = 8 <input type="checkbox"/> ; Excellent = 10 <input type="checkbox"/>	
Comment:	
Passion in Mother and Child care	
Tell us about your interest and passion in Mother and Child care area	
Poor = 2 <input type="checkbox"/> ; Fair =4 <input type="checkbox"/> ; Good = 6 <input type="checkbox"/> ; Very good = 8 <input type="checkbox"/> ; Excellent = 10 <input type="checkbox"/>	
Comment:	
Knowledge about Dartmouth	
Tell us what you know about Dartmouth Medical School and what are your expectations from this exchange program	
Poor = 2 <input type="checkbox"/> ; Fair =4 <input type="checkbox"/> ; Good = 6 <input type="checkbox"/> ; Very good = 8 <input type="checkbox"/> ; Excellent = 10 <input type="checkbox"/>	
Comment:	
Total Marks in Section B:	
Total Marks in Section A and Section B:	

Interviewer 1 Total Marks in Section A and Section B	
Interviewer 2 Total Marks in Section A and Section B	
Interviewer 3 Total Marks in Section A and Section B	
Interviewer 4 Total Marks in Section A and Section B	
Total Final Marks in Section A and Section B:	
Interviewer Name: _____	
Interviewer Signature: _____	

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”

Fakulteti i Mjekësisë



**UDHËZUES PËR HARTIMIN E PUNIMIT TË TEMËS SË
DIPLOMËS PËR STUDIME THEMELORE**

Prishtinë, Maj 2016

Përmbajtja

VËREJTJE TË PËRGJITHSHME	3
Përzgjedhja e temave dhe lloji i tyre	3
Dorëzimi dhe mbrojtja e Temës së Diplomës.....	4
UDHËZIMET TEKNIKE PËR HARTIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS	4
ILUSTRIMET.....	5
SHKURTESAT	5
LIDHJA DHE KOPERTINAT	5
FAQET HYRËSE	6
STRUKTURA E PUNIMIT TË DIPLOMËS	7
INTEGRITETI AKADEMIK.....	7
Mbledhja e të dhënave.....	7
Plagjiarizmi	8
Literatura.....	8

VËREJTJE TË PËRGJITHSHME

Temat e Diplomës duhet të propozohen nga të gjithë mësime të mësimit të Fakultetit të Mjekësisë. Çdo mësime të mësimit duhet të propozoj deri në tetë tema për punimin e diplomës. Shefat e Katedrës duhet të paraqesin propozimin e Temave të Diplomës nga stafi akademik i katedrës përkatëse në fillim të çdo viti shkollor dhe sipas kërkesës së Menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë edhe në periudha tjera.

Vlerësimin e temave të propozuara e bënë Komisioni për Studime Themelore. Duke u bazuar në këto sugjerime dhe vlerësimin e bërë, realizohet regjistrimi i temave për punim diplome të cilat publikohen në faqet e internetit të Fakultetit të Mjekësisë dhe në tabelat e shpalljeve të fakultetit dhe katedrave përkatëse. Bankën e temave të katedrës përkatëse e monitoron shefi i katedrës.

Përzgjedhja e temave dhe lloji i tyre

Studentët nga programet e studimeve themelore (*të integruara dhe bachelor*) fillojnë procedurat për identifikimin e temës dhe mentorit potencial në vitin e fundit të studimeve. Kushti për përzgjedhjen e temës së diplomës është minus 3 provime nga viti i fundit i studimeve. Paraprakisht, studentët duhet të marrin vërtetimin për përmbushjen e këtij kushti nga Shërbimi i Studentëve. Studentët fillojnë procedurat e zyrtarizimit të temës vetëm pas përfundimit të provimit të fundit në kuadër të planprogramit të studimit përkatës.

Kohëzgjatja e përfundimit të temës së diplomës duhet të jetë jo më shumë se 3 muaj nga data e zyrtarizimit të temës. Në raste të caktuara kur studenti nuk ka arritur të përfundojë obligimet për përfundimin e temës për shkak të shëndetësore ose shkak të tjera të arsyeshme për të cilat pajtohen kandidati dhe mentori, atëherë me një arsyetim në formë të shkruar mund të zgjatet edhe për një periudhë maksimale 3 muaj. Në rastet e udhëtimit jashtë vendit për kryerjen e komponenteve të caktuara të Temës së Diplomës, duhet të mirret leja paraprake nga Dekani i Fakultetit të Mjekësisë, para fillimit të punimeve rreth Temës së Diplomës.

Llojet e studimeve në kuadër të Temave të Diplomës mund të jenë:

- *hulumtimet kërkimore-shkencore*
- *rishikimet e literaturës*
- *studimet e rastit*

Dorëzimi dhe mbrojtja e Temës së Diplomës

Punimi i përfunduar i diplomës duhet të dorëzohet në 3 kopje të lidhura tek Shërbimi i Studentëve ndërsa kopja elektronike e temës finale duhet të dorëzohet tek Koordinatori për Cilësi i Fakultetit të Mjekësisë.

Pas pëlqimit të mentorit për gadishmërinë e kandidatit për mbrojtjen e Temës së Diplomës, mbrojtja e temës duhet të bëhet brenda 1 jave pas përfundimit të procedurave përkatëse administrative tek Shërbimi i Studentëve.

Komisioni vlerësues i punimit të Temës së Diplomës përbëhet nga tre anëtarë (kryetari dhe dy anëtarë). Njëri nga anëtarët e komisionit është mentori i kandidatit. Kryetari i komisionit koordinon punën e komisionit dhe nuk duhet të jetë mentori i kandidatit. Anëtarët e tjerë të komisionit i propozon Shefi i Katedrës duke marrë parasysh fushën e aktivitetit shkencor-profesional të Profesorëve përkatës.

Teksti duhet të shkruhet në gjuhën standarde shqipe, në përputhje me rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Përmbledhja e shkurtër e temës së diplomës (Rezimeja) duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

UDHËZIMET TEKNIKE PËR HARTIMIN E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Punimi duhet të ketë të paktën 15 dhe jo më shumë se 50 faqe, duke përfshirë referencat. Duhet të shkruhet në letër të bardhë A4 (210 x 297 mm).

Konfigurimi:

Radhori 1.5

Madhësia e shkronjave 12 pikë tipografike

Lloji i shkronjave (Times New Roman CE).

Frenimi (skaji) majtas 3.5 cm

Frenimi (skaji) lartë 2.5 cm

Frenimi (skaji) poshtë 2.5 cm

Frenimi (skaji) djathtas 2.5 cm

Numërohen të gjitha faqet duke filluar nga hyrja, kurse numri shkruhet poshtë, në mesin e faqes.

ILUSTRIMET

Punimi mund të përfshijë dy lloje ilustrimesh dhe atë: tabela dhe figura (fotografitë, vizatimet, skemat, diagramet, histogramet, hartat, etj). Ilustrimet shënohen me numra arab me renditje sipas paraqitjes së tyre në punim dhe duke respektuar rregullar e referimit të literaturës (shih më poshtë specifikat e referencave). Ato vendosen krahas tekstit ku përshkruhen. Të gjitha figurat duhet të titullohen. Numrat dhe titujt e tabelave vendosen mbi tabelë ndërsa numrat dhe titujt e figurave vendosen nën figurë. Nëse ilustrimi nuk është kontribut origjinal i autorit është e nevojshme të specifikohet burimi (shih më poshtë specifikat e referencave).

SHKURTESAT

Me rastin e futjes së parë të ndonjë shkurtese në punim fillimisht duhet të shkruhet emërtimi i plotë i konceptit, dhe pastaj shkurtesa, e cila futet në kllapa. Më poshtë në tekst mund të përdoret vetëm shkurtesa. Në titullin e punimit nuk mund të përdoren shkurtesa, përveç nëse kuptimi i tyre është përgjithësisht i njohur.

Është e nevojshme të specifikohen të gjitha kuptimet për të cilat në punim do të përdoren shkurtesa dhe përmbledhja e të gjitha shkurtesave të përdorura në tekst duhet të përmblihet në faqen e gjashtë siq është specifikuar më poshtë.

LIDHJA DHE KOPERTINAT

Punimi i diplomës lidhet. Në shtyllën e lidhjes shtypet emri dhe mbiemri i autorit, viti i mbrojtjes dhe llogja e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, Dega përkatëse, emri i mentorit. Faqja e brendshme e kopertinave dhe faqja e parë e cila mbështet në kopertinë mbetet e pashkruar.

Kopertina e parë e punimit të lidhur dhe faqja e parë janë identike dhe duhet të përmbajnë:

- Llogja e Universitetit të Prishtinës (pjesa e sipërme në qendër)
- Titulli i Universitetit të cilit i përket Fakulteti (pjesa e sipërme në qendër, Times New Roman 20, shkronja të mëdha)
- Emri i Fakultetit ku mbrohet punimi i diplomës (pjesa e sipërme në qendër, Times New Roman 18, shkronja të mëdha)

- Emrit i Degës përkatëse (pjesa e sipërme në qendër, Times New Roman 16, shkronja të mëdha)
- Titulli i punimit të diplomës (pjesa e mesme në qendër, Times New Roman 20, shkronja kapitale, bold)
- Emri dhe mbiemri i kandidatit, në pjesën e poshtme majtas (Times New Roman 14, shkronja të vogla)
- Emri dhe mbiemri i mentorit, në pjesën e poshtme djathtas (Times New Roman 14, shkronja të vogla)
- Vendi, muaji dhe viti i realizimit, pjesa e poshtme, mesi i faqes (Times New Roman 14, shkronja të vogla)
- Ngjyra e Kopertinës për studimet themelore duhet të jetë e kuqe (për studimet bachelor e gjelbërt).

FAQET HYRËSE

Faqja e parë është përmbajtësisht dhe teknikisht identike me kopertinën.

Faqja e dytë duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Punimi është bërë në (institucioni, instituti, enti, klinika, etj).
- Mentori (emrin dhe mbiemri, titullin akademik, institucioni)
- Punimi përfshin:(numri)..... faqe; (numri).....Tabela;.....(numri)..... Figura

Faqja e tretë është deklarata e kandidatit në lidhje me vërtetësinë e punimit të diplomës. Një shembull i kësaj deklaratë është si në vijim: *“Deklaroj se kjo Temë e Diplomës është punimi im origjinal. E gjithë literatura dhe burimet tjera që i kam shfrytëzuar gjatë punimit janë të listuara në referenca dhe plotësisht të cituara”*.

Faqja e katërt është fakultative dhe aty mund të shkruhet parathënia, dedikimi apo falënderimet.

Prologu duhet të përfshijë informata relevante për studimin, si emri dhe shenja e projektit në kuadër të të cilit është kryer hulumtimi.

Faqja e pestë është përmbajtja. Përmbajtja përmban listën e të gjithë kapitujve dhe nënkapitujve me faqet ku të njëjtit fillojnë. Faqet shënohen me numra arabë dhe kanë shenjën e faqes ku fillojnë. Përrjashtim bën shtojca e cila, nëse ka të tillë, shënohet në përmbajtje pas jetëshkrimit dhe nuk shënohet me numër arabë.

Faqja e gjashtë përmban listën e shenjave dhe shkurtesave.

Faqet hyrëse (para abstraktit) shkruhen me numra romak dhe nuk numërohen në totalin e faqeve të punimit.

STRUKTURA E PUNIMIT TË DIPLOMËS

Konstrukt i punimit varet nga lloji i punimit. Varësisht nga natyra e punimit të Temës së Diplomës, rekomandohet që struktura e punimit të jetë si në vijim:

- 1. Abstrakti**
- 2. Hyrje**
- 3. Qëllimi i punimit**
- 4. Metodologjia (Subjektet dhe Metodot ose Materialet dhe Metodot)**
- 5. Rezultatet**
- 6. Diskutim**
- 7. Përfundimi**
- 8a. Rezyme**
- 8b. Summary**
- 9. Referencat**
- 10. CV e shkurtër e kandidatit**

INTEGRITETI AKADEMIK

Mbledhja e të dhënave

Në çdo hap të punimit të Temës së Diplomës, duhet të sigurohet mbrojtja e konfidencialitetit dhe ruajtja e anonimitetit të të dhënave personale të pjesëmarrësve të studimit. Mbledhja e të dhënave dhe informatave duhet të respektoj procedurat për mbrojtjen e të dhënave të pacientëve sipas kërkesave të SHSKUK.

Nëse në punim përfshihet pjesëmarrësi-subjekti, para fillimit të realizimit të punimit, duhet të sigurohet pëlqimi i Komitetit Etik. Gjithashtu është e domosdoshme të merret pëlqimi i pjesëmarrësit për ta realizuar punimin. Në rastet tjera të caktuara mentori duhet të shqyrtojë me kandidatin nevojën për aprovimin e mbledhjes së të dhënave nga Komisioni Etik i Fakultetit të Mjekësisë. Në këtë proces kandidati do të përkrahet nga ana e mentorit.

Vërtetësia e të dhënave të grumbulluara dhe materalit tjetër të përdorur për Temat e Diplomës është në përgjegjësi të kandidatit që punon Temën e Diplomës.

Plagjjarizmi

Plagjjarizmi do të monitorohet me rreptësi gjatë gjithë procesit të punimit të Temës së Diplomës. Plagjiati ndodh kur puna ose prona e një studenti apo individi tjetër paraqitet si punë vetanake pa referim adekuat. Prandaj, Temat e Diplomës do t'i nënshtrohen detektimit për plagjjarizëm nga ana e mentorit të temës. Me rastin e dorëzimit të Temës së Diplomës, kandidati është i obliguar që të jep një deklaratë që adreson çështjen e plagjjarizmit.

Literatura

Studentët gjatë shkrimit të Temës së Diplomës duhet respektuar standardet për citime dhe respektim të të drejtave autoriale .

Referencat ndodhen në fund të punimit të Temës së Diplomës dhe pasqyrojnë burimet që autori i ka përdorur gjatë përgatitjes së punimit. Referencat radhiten ashtu si janë paraqitur në tekst, sipas rregullave të International Committee of Medical Journal Editors (<http://www.icmje.org/>) (i njohur më parë si stili *Vancouver*). Shembuj specifik të referencave mund të gjenden në: www.nlm.nih.gov/bsd/uniform_requirements.html.

Revistat duhet të paraqiten me shkurtesat që përdoren në Index Medicus (www.nlm.nih.gov). Rregullat e citimit i merr çdo kandidat bashkë me udhëzimet për hartimin dhe përgatitjen e punimit të diplomës në Shërbimin e Studentëve.

2016

QENDRA INFORMATIVE E BARNAVE



UNIVERSITETI PRISHTINËS

FAKULTETI I MJEKËSISË

DRAFT PROJEKT PROPOZIM

GRUPI PUNUES PËR THEMELIMIN E QENDRËS INFORMATIVE TË BARNAVE NË KOSOVË

PRISHTINË 2016

1 HYRJE

Fakulteti i Mjekësisë rishtazi ka filluar iniciativën e themelimit të Qendrës Informative të Barnave të Kosovës (QIBK). Sistemet shëndetësore të vendeve të ndryshme të botës kanë të organizuara **qendrat informative për barna**, të cilat janë në shërbim primar të popullatës por edhe të profesionistëve mjekësor për ofrimin e informatave në lidhje me barnat e ndryshme në kuptim të përdorimit racional të barnave, respektivisht ngritjes së efikasitetit terapeutik dhe uljes së efekteve të dëmshme në rast të përdorimit jo-adekuat.

Iniciativa e themelimit të QIBK-së ndërmerret duke marrë parasysh rëndësinë e një qendreje të tillë për Kosovën si dhe duke konsideruar kapacitetet ekzistuese profesionale përbrenda Fakultetit të Mjekësisë. Fakulteti i Mjekësisë synon që Qendrën Informative të Barnave ta themelojë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Agjensionin Kosovarë për Produkte dhe Pajisje Medicinale si dhe Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

2 ARSYESHMËRIA E PROJEKTIT

Organizata Ndërkombëtare e Shëndetësisë (OBSH) konsideron qendrat e informimit të barnave si një nga kompetencat kyqe të programeve nacionale që promovojnë përdorimin racional të barnave. Statistikat mjekësore japin të dhëna se puna e këtyre qendrave informative ka ndikuar në mënyrës sinjifikante në uljen e gabimeve gjatë ordinimit të barnave dhe njëkohësisht ka ndikuar edhe në uljen e shkallës së mortalitetit në rast të helmimeve të ndryshme. Një rekomandim zyrtar për ngritjen e këtyre qendrave informative ka dalur edhe nga takimi i mbajtur në vitin 1985 në zyrën qendore të OBSH në Gjenevë.

Informimi mbi barnat duhet të jetë i sakt, i paanshëm, i pavarur dhe me informata faktike. Ky informim duhet të bëhet nga profesionist të trajnuar enkas për këtë qëllim. Qasja në informacion të tillë mbi barnat siguron përdorim, përshkrim dhe dispensim të sakt të barnave dhe rrjedhimisht mbron shëndetin e pacientit.

3. FUNKSIONET KYQE TË QIBK

Puna kryesore e QIBK është e fokusuar në dhënjen e këshillave profesionale për stafin mjekësor si dhe për popullatën e Kosovës për barna dhe preparate herbale si dhe gradualisht me zhvillimin e QIBK-së, edhe dhënjen e informatave për trajtimin e personave që manifestojnë shenja të intoksikimeve medikamentoze.

Me avansimin gradual të kapaciteteve të saj, QIBK do të mund të ofrojë funksionet e mëposhtme:

- *Këshilla terapeutike lidhur me indikacionet terapeutike të barnave, dozën optimale dhe dozën e barit në insuficiencë tëveshkave dhe të mëlçisë, ndërveprimet e barnave, efektet anësore të barnave, rrugën e administrimit, mënyrën e rekonstruimit dhe rritjes e ad-herencës së pacientëve gjatë terapisë*
- *Këshilla për koston e barnave, deponimin, ruajtjen dhe përdorimin e barit në kushte institucionale ose në kushte shtëpiake*
- *Këshilla specifike rreth formulimeve të produkteve farmaceutike*
- *Bashkëpunimi ndërmjet Fakultetit të Mjekësisë, QKUK, AKPM dhe Industrisë Farmaceutike rreth Farmakovigjilencës*
- *Ofrimi i këshillave toksikologjike*
- *Shpërndarja e informatave profesionale për listën e barnave të reja ose atyre obsolete.*
- *Shpërndarja e raportve periodike të sigurisë së barnave (PSUR) për profesionistë shëndetësor*
- *Organizimi i trajnimeve ose sesioneve edukative profesionale për punëtorët shëndetësor ose popullatën*
- *Përkrahja e projekteve hulumtuese shkencore me preparate medikamentoze*
- *Botimi i buletineve periodike të barnave me risi dhe informata për barna*
- *Pjesëmarrja dhe facilitimi i punës kërkimore për stafin akademik dhe shëndetësorë.*

3.1. KUSH PËRFITON NGA QIB?

Benefitet e funksionimit të Qendrave Informative të Barnave janë të deshmuara dhe shumica e shteteve të zhvilluara kanë në dispozicion qendra të tilla. Studimet sygjerojnë që QIB rezulton në përmirësim të rezultateve të pacientit ndërsa përdoruesit e QIB raportohet të kenë një shkallë të lartë të satisfaksionit me këtë shërbim. Në Kosovë, QIBK do të mund të ofronte shërbime profesionale prej të cilave do të përfitonin tre palë kyqe:

3.1.1 Ministria e Shëndetësisë

- QIB do të ndikojë pozitivisht në uljen e problemeve dhe gabimeve me barna në popullatën e Kosovës dhe rrjedhimisht do të ulë numrin e pacientëve që për shkak të problemeve me barna hospitalizohen në spitalet e Kosovës
- Si rezultat i përmirësimit të përshkrimit racional të barnave si dhe uljes së hospitalizimeve të panevojshme nga problemet me barna, QIB do të kursej Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- QIB do të mundësoj ngritjen e kujdesit shëndetësor nga ana e stafit mjekësor ndaj pacientëve që kanë nevojë për informata rreth terapisë së tyre dhe në rast të helmimeve aksidentale dhe suicidale me substance të ndryshme. Kjo do të ndikoj edhe në ngritjen e njohurive në kaudër të edukimit farmaceutik të popullatës dhe do të vetëdijësoj popullatën për përdorim të sigurtë dhe efektiv të barnave.
- QIB do të mundësoj ofrimin e shërbimeve unike, të sistematizuara dhe të shpejta për tërë territorin e Kosovës. Kjo qendër do të jetë e integruar plotësisht në

Sistemin informativ Shëndetsor të Kosovës dhe do të jetë në shërbim të këtij sistemi.

- Në rrethana aktuale qendra informative barnave është komponentë me rëndësi nacionale e shteteve përkatëse, prandaj themelimi i kësaj qendre do të fuqizoj komponentën profesionale dhe shtetërore të Kosovës.

3.1.2 Punëtorët shëndetsorë

- QIB do të ofrojë informacion të sakt, të paanshëm, të pavarur dhe me informata faktike për punëtorët shëndetësorë.
- QIB do të mund të ofrojë edukim të vazhdueshëm në aspektin e barnave për punëtorët shëndetësorë.
- Përmes kësaj qendreje punëtorët shëndetësorë do të jenë të informuar vazhdimisht për risitë në fushën e farmakoterapisë, e njokohësisht do të marrin përkrahje profesionale për trajtimin e pacientëve të helmuar deri sa të arrijnë në institucionin shëndetsor të specializuar toksikologjik.

3.1.3. Popullata e Kosovës

- Popullata e Kosovës do të përfitojë nga QIB sepse do të arrij deri te informacionet për përdorimin e sigurtë dhe efikas të barnave.
- Pacientët do të kenë mundësinë e këshillimit të profesionistëve të QIB në aspektin e përdorimit racional të barnave të përshkruara, efekteve të mundshme

anësore, toksicitetit si dhe arritjes dhe mirëmbajtjes së komplaincës ndaj terapisë së përshkruar.

- Si rezultat i përdorimit të drejtë të barnave, pacientët do të arrijnë rezultate më të mira gjatë trajtimit të sëmundjes dhe rezultate më të mira të trajtimit në kuptim të përmirësimit të statusit funksional të të sëmurëve, ose të kualitetit të jetës së tyre.

4. REZULTATET E PRITURA TË QIBK

Puna e kësaj qendra është e bazuar në dhënjen e informatave për barna përmes formave të komunikimit të shpejtë, siç janë linjat telefonike dhe të internetit, raporteve të shkruara apo edhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë në rast të trajnimeve të stafit shëndetësorë apo këshillimit të pacientëve.

Përfundimisht, puna në këtë qendër do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në:

1. Ngritjen e efikasitetit të terapisë mendikamentoze

2. Përmirësin e nivelit të sigurisë së barnave dhe parandalimin e manifestimit të efekteve anësore serioze

3. Përmirësimin e përdorimit dhe përshkrimin racional të barnave si dhe uljen e gabimeve me barna

4. Rritjen e kost-efektivitetit të barnave dhe ngritjen e njohurive profesionale për barna të gjithë punëtorëve shëndetësor

5. Shpërndarjen e informatave për barna në mënyrë profesionale, sistematike, konstante dhe në arritjen e këtyre informative në të gjitha pjesët e vendit madje edhe në ato pjesë ku nuk ka mundësi për infrastrukturë të zhvilluar shëndetësore, si në vendet e ndryshme rurale.

5. NEVOJAT KYQE TË THEMELIMIT TË QIBK

QIBK duhet të disponojë me staf profesional në fushën e farmacisë përkatësisht të farmacisë klinike, kujdesit farmaceutik, farmacisë komunitare e spitalore, farmakologjisë klinike dhe toksikologjisë klinike që janë të trajnuar të japin edhe këshilla profesionale në kuadër të kompetencave dhe përtgjegjësiwe profesionale të tyre. Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës në këto qendra, rekomandohet organizimi i punës së këtyre qendrave në koordinim dhe bashkëpunim me qendra të natyrës së njëjtë të vendeve fqinje ose qendrave referente duke krijura një rrjetë të funksionimit të tyre.

Federate Ndërkombëtare Farmaceutike ka përpiluar disa rekomandime specifike që duhet konsideruar gjatë themelimit të QIB në aspektin e resurseve të nevojshme. Në këtë aspekt duhet konsideruar:

- *Resurset humane*
- *Involvimin i ekipit multidisciplinarë*
- *Trajnimin adekuat dhe të vazhdueshëm*

- *Libraritë, Databazat*
- *Kompjuterët dhe pajisjet tjera*

Duke konsideruar edhe rekomandimet e mësipërme të Federatës Ndërkombëtare Farmaceutike mbi resurset e nevojshme për themelimin e QIB, fillimisht është i rëndësishëm që fokusi për themelimin e QIBK të fokusohet në 2 aspekte kyçe: resurset humane dhe resurset fizike e infrastrukurore.

5.1. Resurset humane

Në kuadër të grupit të ekspertëve të përzgjedhur sipas vendimit të Menaxhmentit të Fakultetit të Mjekësisë, janë përfshirë ekspertë nga fusha e farmacisë dhe mjekësisë së përgjithshme në lëmitë e ndryshme profesionale, si farmakolog klinik, farmacist klinik, farmacist komunitarë, specialist nga fusha e kontrollit të barnave, të farmakovigjilencës, të toksikologjisë laboratorike dhe fushave tjera.

Për funksionimin e kësaj qendre nevojitet një kordinim dhe bashkëpunim i aktiviteteve edhe me Ministrinë e Shëndetësisë të Kosovës, Agjencionin e Kosovës për Produkte Medicinale, Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe Institucioneve tjera. Me qëllim të krijimit të kushteve të vazhdimësisë së punës së kësaj qendre propozohet që të gjitha këto institucione të kordinohen, respektivisht Ministria e Shëndetësisë të Kosovës, Ministria e Shëndetësisë dhe Universiteti i Prishtinës në mënyrë që stafit t'i ofrohen kontrata për marrëdhënie pune për një pjesë të stafit që do të jenë të përhershëm në punën e kësaj qendre me rëndësi nacionale.

Me fillimin e punës së QIBK, propozohet që të konsiderohet binjakizimi i QIBK me QIB relevante ndërkombëtare në mënyrë që QIBK të përfitojë në aspektin e resursve njerëzore nëpërmjet trajnimit të mëtutjeshëm të stafit të QIBK-së në QIB përkatëse.

5.1.1 Trajnimi stafit

Funksionimi i suksesshëm i QIBK është ngusht i ndërlidhur me trajnimin specifik të stafit në fushën e informimit të barnave. Këtu përfshihen aspekte të rëndësishme siq janë: aftësitë komunikuese, njohja me shfrytëzimin e pajisjeve dhe literaturës në dispozicion, aftësitë e navigimit të informacionit dhe përdorimit të drejtë të tij, analizim i rezultateve komplekse të studimeve, aftësitë e shkrimit dhe analizës kritike. QIBK do t'i realizoj këto trajnime duke përdorur stafin ekzistues si dhe në bashkëpunim të ngusht me qendrat ndërkombëtarë të informimit të barnave me të cilat do të binjakizohet.

5.2. Resurset teknike dhe infrastrukurore

Në organizimin e punës së QIB do të jenë të përfshirë Fakulteti i Mjekësisë, Dega e Farmacisë, Instituti i Farmakologjisë Klinike dhe institucionet tjera relevante.

Fillimisht, për funksionalizimin e kësaj qendre për momentin nevojiten:

- a. Hapësira Fizike (që sigurohet nga Fakulteti i Mjekësisë).
- b. Pajisje softwerike (programe kompjuterike profesionale me të dhëna mbi barnat dhe helmet) dhe hardverike për krijimin e bazës së informative.

BUXHETI I NEVOJSHËM PËR THEMELIMIN E QIBK

Funksionalizimi i lokacionit të identifikuar	€ 40,000
Kompjuterë (X 5)	€ 3,500
Databaza elektronike (p.sh. Micromedex)	15,000
Literature (libra)	€2,000
Telefona (X5)	€250
Linja telefonike	€300
Interneti	€500
Trajnim i stafit	€ 20,000
Pajisje të zyreve	€ 4,000
Printer dhe furnizime për zyre	€2,000
Totali	€87,550

Referencat

1. Promoting rational use of medicines: core components. WHO Policy Perspectives on Medicines, September 2002.
2. Bertsche T, Hammerlein A, Schulz M. German national drug information service: user satisfaction and potential positive patient outcomes. *Pharmacy World and Science* 2007; 29:167-172
3. Kimland E, Bergman U, Lindelmalm S, Bottiger Y. Drug related problems and *off-label* drug treatment in children as seen at a drug information centre. *European Journal of Pediatrics*. 2007; 166:527-532
4. FIP Pharmacy Information Section. Requirements for Drug Information Centres
5. Godlee F, Pakenham-Walsh N, Ncayiyana D, Cohen B, Packer A. Can we achieve health information for all by 2015? *Lancet* 2004; 364: 295-300.
6. Management Sciences for Health. 2012. MDS-3: Managing Access to Medicines and Health Technologies. Arlington, VA: Management Sciences for Health



FAKULTETI I MJEKËSISË

RAPORT I VLERËSIMIT TË VAZHDUESHËM TË STUDENTËVE

LËNDA: Zgjedhe lëndën

DEGA: Zgjedhe degën

DATA: Zgjedhe datën

VITI AKADEMIK: Zgjedhe vitin

SEMESTRI: Zgjedhe semestrin

1. LLOJET E VLERËSIMEVE

Llojet e vlerësimeve të lëndës:

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Kliko këtu dhe zgjedhe vlerësimin

Data e realizimit të vlerësimit:

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

Kliko këtu dhe zgjedhe datën

2. INTEGRITETI AKADEMIK GJATË VLERËSIMIT

a) Integriteti themelorë akademik

Mbikqyren të gjitha vlerësimet nga Profesori/Asistenti

Po Jo EPA*

Verifikohet identiteti i studentëve gjatë vlerësimit

Po Jo EPA

Përdoren metoda që parandalojnë plagjiazmit

Po Jo EPA

*EPA=e pa-aplikueshme

DATA: Zgjedhe datën

VITI AKADEMIK: Zgjedhe vitin

SEMESTRI: Zgjedhe semestrin

b) Vlerësimi i drejtë i studentëve

Vlerësimet koordinohen dhe pajtohen nga të gjithë mësimmshënësit e lëndës Po Jo EPA

Vlerësimet rishikohen dhe kanë të dizajnuara çelësin e pyetjeve Po Jo EPA

Është caktuar bashkëvlerësuesi nga e njëjta lëndë (kur lënda ligjrohet nga më shumë se një Profesor) Po Jo EPA

Bashkëvlerësuesi ka rishikuar pyetjet dhe çelësin e pyetjeve para vlerësimit të studentit Po Jo EPA

Vlerësimi është bazuar në literaturë të përditësuar dhe të raportuar në syllabusin e lëndës Po Jo EPA

c) Regjistrimi i notimit të studentëve

Notat janë regjistruar në SEMS brenda afatit kohorë Po Jo EPA

Ndryshimi notave në SEMS është bërë brenda afatit kohorë Po Jo EPA

Notat e studentëve janë regjistruar në librin e protokolit Po Jo EPA

d) Moderimi i vlerësimeve

Studentët janë njoftuar në syllabus dhe në fillim të semestrit për komponentët e vlerësimit të vazhdueshëm të lëndës Po Jo EPA

Studentët janë të njoftuar me kriteret e notimit për të gjitha komponentet e vlerësimit të lëndës Po Jo EPA

Gjatë vlerësimit të punës seminarike përdoren rubrikat e vlerësimit për të siguruar vlerësim konsistent Po Jo EPA

Në rastet kur studenti arrinë pikë në kufi të notës tjetër, rivlerësohet testi/provimi Po Jo EPA

Në rastet kur studenti vlerësohet nga >2 vlerësues dhe ka diskrepancë të notimit, testimi rivlerësohet Po Jo EPA

PROFESORI I LËNDËS: Kliko këtu dhe shkruaj emrin dhe mbiemrin e bartësit të lëndës

